



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28/2022 regjistër (JR)  
Datë 23.06.2022

Nr. 33 i vendimit  
Datë 28.04.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 28.04.2025, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Fida Osmani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 525, datë 27.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Fida Osmani.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66 pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës si Shqipërisë”; nenet 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkuarve të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), sipas së cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 525, datë 27.04.2022 dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Në lidhje me rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fida Osmani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të Gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

1.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas së cilit: (i) *deklarimet e subjektit ndër vite, nuk janë të sakta në përputhje me ligjin; (ii) është i paqartë burimi financiar i përdorur për transaksionet e konfirmuara nga DPPPP-ja<sup>1</sup>; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Komisioni përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar të kryer mbi bazën e *kriterit të rivlerësimit të pasurisë*, duke konkluduar me masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra*, nëpërmjet vendimit objekt shqyrtimi, me nr. 525, datë 27.04.2022. Arsyetimi i Komisionit përmbledhet në vijim.

#### **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra, u bazua në përfundimet e arritura për pasuritë e shqyrtuara, të cilat u vlerësuan të mjaftueshme për të konkluduar mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni vendosi të mos çelë hetimin administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit profesional, të kërkuar në seancë dëgjimore nga përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit. Përfundimisht, Komisioni vlerësoi se subjekti ndodhet në kushtet e shkarkimit nga detyra sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim u bazua në konkluzionet përfundimtare për kriterin e pasurisë, si më poshtë vijon:

---

<sup>1</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, aktualisht me emërtimin Agjencia e Inteligjencës Financiare.

3.1. Për pasurinë *apartament banimi me sipërfaqe 95,6 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur ndodhen në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk kanë deklaruar dhe përfshirë në deklaratën *vetting* këtë pasuri, për të cilin kishin marrë hapa ligjorë dhe kishin kryer pagesa shoqërisë ndërtuese.

3.2. Subjekti i rivlerësimit, *ndodhet në situatën e konfliktit të interesit* sipas parashikimit të gurmës “d”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore ku palë ka qenë shoqëria “{\*\*\*}” ShPK apo përfaqësuesi i saj ligjor.

3.3. Për pasurinë *njësi shërbimi*, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pagesën e kështit të parë të njësisë së shërbimit, duke rezultuar me një balancë negative në vitin 2010, në vlerën 1.003.580 lekë; për vitin 2012 në vlerën 1.357.110 lekë; në vitin 2013 në vlerën 2.898.089 lekë. Vlera e deklaruar në deklaratën *vetting* nuk është vlera e dakordësuar prej palëve në kontratën e shitblerjes më 08.02.2013.

3.4. Për pasurinë *automjet, i llojit “Mercedes-Benz” {\*\*\*}*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie, me një balancë negative prej (-) 1.182.252 lekësh. Subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të po këtij ligji.

### **III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit**

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim kundër vendimit të Komisionit, bazuar në dispozitat ligjore të referuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi të Kolegjit. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të vendosë prishjen e vendimit objekt ankimi dhe dërgimin e çështjes Komisionit, për të vazhduar më tej me procedurën e rivlerësimit për dy kriteret e mbetura pa u vlerësuar. Në alternativë, subjekti kërkon gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe çeljen e shqyrtimit gjyqësor, qoftë për konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese e konventore, ashtu edhe për vlerësimin e drejtë të provave, konstatimin e drejtë të gjendjes faktike dhe kryerjen e një analize të drejtë financiare. Subjekti i kërkon Kolegjit të kryejë hetimin e dy kriterëve të tjera dhe në përfundim, të vendosë ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

4.1. Në datën 22.04.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj parashtrime të pashoqëruara me akte. Edhe në këto parashtrime, ajo ka kërkuar çeljen e hetimit qoftë për kriterin e pasurisë ashtu edhe për dy kriteret e tjera. Ajo argumenton se Komisioni ka keqinterpretuar faktet dhe provat, duke çuar në një vendimmarrje të padrejtë. Në vendim nuk janë përfshirë gjetjet e pasqyruara në raportin e rezultateve të hetimit, për të cilat ajo arriti të provojë të kundërtën. Procesi i rivlerësimit ka qenë i paragjykuar që në fillimet e tij dhe ndaj subjektit është marrë një vendim i nxituar dhe i njëanshëm, i cili e ka privuar nga vazhdimi i detyrës dhe i ka cenuar dinjitetin pas një karriere të gjatë në sistemin e drejtësisë.

4.2. Argumentat e subjektit në shkaqet e ankimit dhe në parashtrimet në Kolegj, janë grupuar në vijim sipas natyrës së tyre, në shkaqe me natyrë procedurale që lidhen me procesin e rregullt

ligjor dhe në shkaqe që lidhen me themelin e çështjes e konkretisht, kundërshtime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

### **III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale**

5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit të zhvilluar në Komision, i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në shkelje të neneve 42 e 179/b, pika 2 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj, nenit 4, pikat 5 e 6 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 52, pika 1 të të njëjtit ligj. Komisioni nuk ka zbatuar parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Subjektit i është mohuar e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta për tu mbrojtur në mënyrë efektive dhe drejtësisht, në shkelje të parimeve të barazisë së palëve dhe të kontradiktoritetit. Vendimi i Komisionit është i padrejtë pasi është bazuar në një hetim dhe vlerësim administrativ të paplotë. Pretendimet konkrete janë si vijon:

5.1. Përbërja e trupës gjyquese nuk është e njëjtë me atë që i është njoftuar me email në fillim të procesit të rivlerësimit. Në vend të anëtarit Lulzim Hamitaj, sipas njoftimit, subjektin e rivlerësimit e ka gjykuar anëtari Olsi Komici, për të cilin ajo nuk ka pasur asnjë komunikim nga Komisioni. Në kushtet e padijenisë mbi këtë situatë, subjekti është shprehur se nuk ka kundërshtim për asnjërin nga Komisionerët. Subjekti pretendon (me rezervë për shkak të mospasjes së provave), se pas përfundimit të seancës dëgjimore është vënë në dijeni se anëtari Olsi Komici, kishte kërkuar më herët të mos jetë pjesë e trupës gjyquese;

5.2. Komisioni nuk i dha kohën e nevojshme për të paraqitur provat në përgjigje të barrës së provës. Ky fakt dëshmon që Komisioni e kishte marrë “*de facto*” vendimin dhe kalimi i barrës së provës ishte vetëm “një formalitet” dhe jo një garanci reale për një proces të rregullt ligjor;

5.3. Provat e siguruar pas dorëzimit të relacionit shpjegues deri në datën e seancës dëgjimore, nuk janë çmuar për efekt të vendimarrjes së Komisionit dhe nuk i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar, duke qenë se nuk kishte kohë efektive që materiali i paraqitur të përkthehej. Dy aktet e depozituara në seancë dëgjimore nuk citohen në vendim, përpos që as i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar;

5.4. Komisioni nuk i ka njoftuar subjektit rezultatet e pritshme të procedurës administrative, krahas rezultateve të hetimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 87, pika 2, gërma “ç”, e ligjit nr. 44/2015;

5.5. Pa përmbushur detyrimin kushtetues për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të fakteve, Komisioni, i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrë prove të paarsyeshme, jo propocionale dhe jo objektive, për gjetje të rënda, të cilat “paravendosën” vendimarrjen.

### **III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë**

6. Konkluzionet e Komisionit në vendimin përfundimtar, janë të gabuara pasi nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë e të paanshëm të provave të administruara nga Komisioni gjatë këtij procesi, dhe i shpjegimeve e provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës.

6.1. Gjetjet pas kalimit të barrës së provës, të cilat duhej të ishin pjesë e arsytimit të vendimit, nuk janë pasqyruar e analizuar në vendim;

6.2. Subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurive. Të dhënat e paraqitura në deklaratën *vetting*, janë të vërteta dhe të sakta. Ajo nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Në kushtet ku pasaktësitë e konstatuara nuk dëshmojnë përpjekje të subjektit për të fshehur apo për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim, ato nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore. Vlera e pasurive në pronësi, justifikohet me të ardhurat e ligjshme të familjes së saj dhe nuk e kalon pragun e dyfishit të pasurisë së ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ligjore është e aplikueshme vetëm kur deklarimi i pamjaftueshëm vërtetohet në mënyrë kumulative për kriterin e pasurisë dhe kontrollin e figurës dhe si e tillë nuk mund të gjejë zbatim në rastin e saj, pa iu nënshtruar kontrollit të dy kriterëve të tjera të vlerësimit, përpos atij të pasurisë. Për rrjedhojë, gjetjet e Komisionit nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

6.3. Pretendimet konkrete për secilën pasuri të ankimuar, shtjellohen në vijim të këtij vendimi të Kolegjit.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj**

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 30.06.2022, i cili është publikuar në internet, në faqen zyrtare të Kolegjit<sup>2</sup>.

###### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

8. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt dhe *ratione temporis*, në kushtet që ankimi është depozituar në Komision në datën 17.06.2022<sup>3</sup>, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar,<sup>4</sup> në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### *iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

---

<sup>2</sup> <https://kpa.al/events/njoftim-4/>

<sup>3</sup> Regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot, datë 17.06.2022.

<sup>4</sup> Vendimi i arsyetuar i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, në datën 02.06.2022.

9. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin në dhomë këshillimi, nën dritën e pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012<sup>5</sup>, të thirrur për zbatim nga neni 65, pika 1, e ligjit nr. 84/2016. Pasi analizoi kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit referuar më sipër, trupi gjykues çmoi se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj, që do të diktonin nevojën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit. Ky vlerësim përfshin analizën e kryer qoftë për shkaqet procedurale apo edhe atë të vlerësimit të rrethanave faktike, përcaktuar nga neni 51, i ligjit nr. 49/2012. Konkretisht, subjekti nuk ka depozituar prova të reja që lejohen me ankimin në kuptim të nenit 47, të ligjit nr. 49/2012, por ka pretenduar shkelje të rënda procedurale dhe nevojën për shqyrtim të akteve që administrohen në dosjen e Komisionit. Nga vlerësimi i konkluzioneve të Komisionit dhe i pretendimeve në ankim e parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi asnjë shkelje procedurale të rëndë, apo konstatim të gabuar të situatës faktike, që do të passillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegji, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre. Në analizën e kryer nga Kolegji kryesisht, rezultoi se: (a) Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

## ***B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit***

### ***B.1. Analiza e shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale***

10. Sikurse përmbledhur më lart në kreun III/1 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se në Komision i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor parashikuar nga neni 6 i KEDNj, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e panashme, e drejta për tu mbrojtur në mënyrë efektive dhe drejtësisht, si rezultat i mosrespektimit të parimeve të kontradiktoritetit, barazisë së armëve dhe vendimit të paarsyetuar. Këto të drejta i janë mohuar si pasojë e shkeljeve procedurale të cilat në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si vijon:

**10.1.** Përbërja e trupës gjyqëse nuk është e njëjtë me atë që i është njoftuar me email në fillim të procesit të rivlerësimit. Në vend të anëtarit Lulzim Hamitaj, sipas njoftimit, subjektin e rivlerësimit e ka gjykuar anëtari Olsi Komici, për të cilin ajo nuk ka pasur asnjë komunikim nga Komisioni. Në kushtet e padijenisë mbi këtë situatë, subjekti është shprehur se nuk ka kundërshtim për asnjërin nga Komisionerët. Subjekti pretendon (me rezervë), se pas përfundimit të seancës dëgjimore është vënë në dijeni se anëtari Olsi Komici, kishte kërkuar më herët të mos ishte pjesë e trupës gjyqëse.

**10.2.** Subjektit i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur në mënyrë efektive dhe drejtësisht, pasi Komisioni nuk i dha kohën e nevojshme për të paraqitur provat në përgjigje të barrës së provës. Ky fakt dëshmon që Komisioni e kishte marrë vendimin dhe kalimi i barrës së provës ishte vetëm formalitet dhe jo një garanci reale për një proces të rregullt ligjor. Provat e siguruar pas dorëzimit të relacionit shpjegues deri në datën e seancës dëgjimore, nuk janë çmuar për efekt të vendimmarrjes së Komisionit dhe nuk i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar, duke qenë se nuk kishte kohë efektive që materiali i paraqitur të përkthehej. Dy aktet e

---

<sup>5</sup> Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

depozituara në seancë dëgjimore nuk citohen në vendim, përpos që as i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar.

**10.3.** Komisioni, pa përmbushur detyrimin kushtetues për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të fakteve, i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit barrë prove të paarsyeshme, jo propocionale dhe jo objektive, për gjetje të rënda, të cilat paravendosën vendimmarrjen.

**10.4.** Komisioni nuk i ka njoftuar subjektit rezultatet e pritshme të procedurës administrative, krahas rezultateve të hetimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 87, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 44/2015. Komisioni duhej t’i bënte me dije subjektit edhe faktin nëse një gjetje konkrete mund të çonte drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra apo të ndonjë mase tjetër, në mënyrë që subjekti të kishte mundësinë të ushtronte të drejtën për të provuar të kundërtën.

**11.** Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin në respektim të garancive kushtetuese e konventore për proces të rregullt. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Ky vlerësim u bazua në situatën ligjore dhe faktike, që rezultoi nga verifikimi i pretendimeve konkrete të potencuara në ankim, shtjelluar gjerësisht në vijim të këtij vendimi.

**11.1.** Pretendimi se i është mohuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për shkak se në përbërje të trupës gjykuese ka qenë edhe z. Olsi Komici, u vlerësua i pambështetur në prova. Nga shqyrtimi i akteve rezulton se pretendimi i subjektit se nuk është vënë në dijeni për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues rezulton i pavërtetë, referuar akteve në dosje. Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 21.04.2022, rezulton se ky pretendim është ngritur në atë seancë nga përfaqësuesja e subjektit, av. A. S., menjëherë pas përfundimit të relativitetit të çështjes nga anëtarin relator. Pasi trupi gjykues i Komisionit u tërhoq për të verifikuar këtë pretendim, kryesuesja sqaroi në seancë se pasi subjektit i është njoftuar<sup>6</sup> fillimi i hetimit administrativ me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine dhe Lulzim Hamitaj, në datën 09.05.2020, disa ditë më vonë, në datën 18.05.2020, Komisioni ka njoftuar subjektin për *saktësimin* e trupës gjykuese, e cila përbëhet nga komisionarët Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine dhe Olsi Komici dhe i ka kërkuar asaj të deklarojë konfliktin e interesit me trupën gjykuese. Pavarësisht sqarimeve të dhëna më parë, në atë seancë subjektit iu rikërkua të shprehet lidhur me konfliktin e interesit për anëtarin e trupit gjykues, z. Komici. Subjekti deklaroi se nuk ka marrë e-mail të dytë, por gjithsesi konfirmoi *mospasjen* e ndonjë konflikti interesi me komisionierin Olsi Komici dhe se është dakord me trupin gjykues. Pretendimi i subjektit për mosmarrjen e një email-i të dytë rezulton i pavërtetë, pasi në dosjen e Komisionit ndodhet i administruar e-maili i datës 18 maj 2020, i dërguar nga Komisioni në adresë të subjektit, përmes të cilit është komunikuar trupa gjykuese në përbërje të së cilës ishte komisioneri në fjalë.

**11.2.** Subjekti pretendon se pas përfundimit të seancës dëgjimore është vënë në dijeni se i njëjti komisioner kishte kërkuar të hiqte dorë. Nga aktet në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues i

---

<sup>6</sup> E-mail, datë 09.05.2020, ora 09:36.

Kolegjit vëren se komisioneri Olsi Komici ka paraqitur kërkesë për heqje dorë<sup>7</sup>, më datë 18.12.2019. Trupi tjetër gjykues, i shortuar për këtë qëllim, ka vendosur mospranimin<sup>8</sup>. Mbi këtë bazë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Fakti që një komisioner tregon vëmendje të veçantë të shmangë situata të cilat mund të shiheshin nga subjekti si arsye serioze njëanshmërie, nuk mund të konsiderohet se barazohet me pengesa ligjore që ndalojnë pjesëmarrjen në një trup gjykues.

**11.3.** Nga ana tjetër nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur ndonjë pretendim apo ndonjë situatë konkrete, që mund të vinte në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e komisionerit Komici në gjykimin e çështjes. E kundërta rezulton nga aktet, sipas të cilave subjektit i është dhënë mundësia për t'u shprehur lidhur me konfliktin e interesit jo vetëm gjatë hetimit administrativ në komunikimin elektronik të datës 18.05.2020, por edhe në seancë dëgjimore. Në atë seancë, subjekti i rivlerësimit është shprehur se është *krejt dakord* me trupin gjykues. Për më tepër, pretendimet për konflikt interesi, nuk mund të ngrihen në fazën e ankimit të çështjes në Kolegj, pasi subjekti nuk pretendon ndonjë situatë të re, të lindur/apo të ardhur në dijeni pas përfundimit të procesit të rivlerësimit në Komision. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit për mohim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paaanshme është i pakuptimtë dhe i pabazuar.

**11.4.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, pasi Komisioni nuk i dha kohën e nevojshme për të paraqitur provat që i konsideronte të domosdoshme, po ashtu nuk gjen mbështetje në akte sikurse edhe argumentat sipas të cilave Komisioni e kishte marrë vendimin dhe kalimi i barrës së provës ishte vetëm formalitet. Konkretisht, Komisioni i njoftoi subjektin rezultatet e hetimit me email-in e datës 31.03.2022, duke i komunikuar njëkohësisht edhe datën 18.04.2022, si afatin maksimal për dërgimin e shpjegimeve dhe provave. Në datën 01.04.2022, subjekti i rivlerësimit kërkoi çeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera si edhe zgjatjen e afatit, me të paktën 30 ditë kalendarike, pasi afati 18-ditor nuk i mjaftonte për realizimin e mbrojtjes. Me email-in e datës 04.04.2022, Komisioni njoftoi subjektin se, në kushtet që provat për kriterin e pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, kërkesa për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera nuk u pranua. Kjo kërkesë do të rivlerësohej pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit, në varësi të nivelit të provueshmërisë të shpjegimeve për kriterin e pasurisë. Në të njëjtin email, Komisioni rikonfirmoi afatin 18 ditë, të njoftuar me rezultatet e hetimit.

---

<sup>7</sup> Kërkesa për heqjen dorë bazohet në argumentin se, vëllai i subjektit të rivlerësimit ka qenë vartës i kunatit të komisionerit dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre kanë qenë të acaruar si gjatë zgjidhjes së marrëdhënieve të punës ashtu edhe pas kësaj periudhe. Komisioneri Komici sqaron se përpara zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, është takuar disa herë me vëllanë e subjektit por jo pas zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ndonëse ai ka kërkuar ta takojë, për arsye të cilat komisioneri nuk i di. Në këto kushte, komisioneri Komici, vlerëson se pjesëmarrja e tij në këtë trupë gjykuese, mund të shihet nga subjekti si një arsye serioze për njëanshmëri në proces.

<sup>8</sup> Me vendimin e datës 16.01.2020, trupi gjykues i Komisionit arsyeton se: "nuk përmbushen kërkesat e nenit 3, pika 4, shkronjat "b" dhe "c" të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit", dhe se nuk krijohet bindja se ekziston dyshimi i paanshmërisë në gjykim të kërkuarit [...], kërkuari nuk parashtron në kërkesë ndonjë fakt apo rrethanë që e vendosin atë në kushtet e pamundësisë për të qenë objektiv. Faktet e referuara në kërkesë, në asnjë rast nuk mund të perceptohen si marrëdhënie personale, apo të interpretohen si provë e mungesës së objektivitetit në gjykimin dhe vendimmarrjen e z. Komici në cilësinë e Komisionerit të KPK-së."

**11.5.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se afati 18-ditor që ka vendosur Komisioni, është në përputhje me afatet e përcaktuara në aktet nënligjore të Komisionit<sup>9</sup>. *Së dyti*, subjekti nuk ka specifikuar ndonjë arsye konkrete që e pengonte/vononte në sigurimin e provave. Mungesa e specifikimit të dokumentacionit që nevojitej apo aspekti konkret i gjetjeve të Komisionit që e bënte të domosdoshme zgjatjen e kohës në atë fazë, si dhe fakti që as në vijim, në asnjë fazë, përfshirë edhe me ankimin e parashtrimet në Kolegji, subjekti nuk ka konkretizuar me akte apo argumenta nevojën për kohën shtesë të kërkuar për përmbysjen e barrës së provës, më shumë sesa nevojë procedurale të mirëfilltë, nuk mund të argumentohet përveçse si përpjekje për të zvarritur procesin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, në kushtet që procesi i rivlerësimit është i kufizuar në kohë, kohëzgjatja e procesit nuk mund t'i nënshtrohet shtyrjeve të pakonkretizuara për arsye të paspecifikuara të subjekteve. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar dhe i paargumentuar.

**11.6.** Sa i përket pretendimit për mosvënien e provave të depozituara pas dorëzimit të relacionit shpjegues në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton të kundërtën. Sipas procedurës që ndjek Komisioni në zbatim të rregullave të miratuara prej tij për mënyrën e funksionimit<sup>10</sup>, shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas njoftimit të rezultateve të hetimit, i janë komunikuar vëzhguesit ndërkombëtar, përmes relacionit përfundimtar. Ky fakt provohet edhe nga vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 19.04.2022, sipas të cilit, trupi gjykues në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, u mblodh për të dëgjuar relatimin mbi hapat e ndërmarrë, gjendjen e akteve, *provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti*. Bazuar në këto akte, rezulton se vëzhguesi ndërkombëtar ka ardhur në dijeni të shpjegimeve e provave të depozituara nga subjekti deri në këtë fazë. Më tej, duke qenë i pranishëm në seancë dëgjimore dhe i asistuar nga përkthyesi, vëzhguesi ndërkombëtar është njohur edhe me provat e depozituara në këtë seancë<sup>11</sup>. Për më tepër, në kushtet që gjatë seancës dëgjimore vëzhguesi ndërkombëtar dhe subjekti i rivlerësimit kanë zhvilluar një dialog lidhur me një pasuri në {\*\*\*}, Golem<sup>12</sup>, ky pretendim i subjektit duket i pakuptimtë. *Së fundmi*, edhe bisedimet për marrjen e vendimit janë zhvilluar në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Të gjitha këto elemente konkrete, sikurse edhe fakti që në fashikull nuk ka gjurmë të ndonjë rrethane që të tregojë se vëzhguesit i është mohuar aksesi në akte, tregojnë që procesi i rivlerësimit është

---

<sup>9</sup>Pika 6, shkronja “f” e dokumentit të miratuar “Hapat Proceduralë të Unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, parashikon që afati nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u njohur me dosjen.

<sup>10</sup> Hapat Proceduralë të Unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, miratuar me vendim të Komisionit.

<sup>11</sup> Në seancë dëgjimore u depozituan këto prova: (i) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 15.04.2022, lëshuar nga FShU Tiranë; (ii) akt ekspertimi nr. {\*\*\*}, datë 20.04.2022; (iii) shkresë e BKT nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2022, bashkëlidhur së cilës ka mandatarkëtimesh. Këto prova janë depozituar në funksion të konstatimeve që lidhen me pasurinë njësi shërbimi të blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, dhe transaksionin depozitim në cash në shumën 17.000 euro për llogari të shoqërisë {\*\*\*} ShPK, për blerje të një pasurie të paluajtshme në Golem.

<sup>12</sup> Reflektuar në faqet nr. 30-31 të procesverbalit të seancës dëgjimore, ku vëzhguesi ndërkombëtar, ndër të tjera, e pyet subjektin e rivlerësimit lidhur me apartamentin në Malin e Robit, Golem dhe dokumentet që disponon. Subjekti është përgjigjur se “Është gjetur kontrata e shitjes, kemi siguruar kontratën e shitjes të kësaj pasurie, e kemi vënë në dispozicion të Komisionit, unë e kam dhe gjendje këtu, të noterizuar. Blerësi është [...] K. O., atësia është R., bashkëshorti im e ka M.. Ai është i datëlindjes '55, bashkëshorti im është i datëlindjes '52. Ai ka lindur në Tiranë, bashkëshorti im ka lindur në Dibër dhe mbi të gjitha këto, nënshkrimi i kontratës dhe nënshkrimi i mandateve me të cilën është bërë pagesa e kësaj vile, nuk janë nënshkrimet e bashkëshortit tim. Për këtë, paraqita një akt ekspertimi pasi vetëm dje mu vunë në dispozicion këto prova. Dhe në kohën e shkurtër që kisha për ti kundërshtuar, bëra një ekspertim grafik. Nuk kam pasuri në Malin e Robit dhe as në Qerret. Nuk kam as apartament vilë 3-katëshe”.

kryer në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, përfshirë edhe për sa i përket të drejtës dhe përgjegjësisë së vëzhguesit ndërkombëtar për të monitoruar e mbikëqyrur gjithë procesin dhe mbështetur Komisionin nëpërmjet pasjes dijeni të gjithë zhvillimeve dhe akteve të administruara në Komision gjatë gjithë hetimit administrativ.

**11.7.** Subjekti pretendon se provat e dorëzuara prej saj, në formën e kërkuar nga ligji, nuk janë çmuar për efekt të vendimarrjes së Komisionit. Trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt ankimi, janë arsyetuar kryesisht provat e depozitura me prapësimet, ndërkohë që vërehet një mungesë referimi i provave të depozituara në seancë dëgjimore. Megjithatë, referuar seancës së shpalljes së vendimit<sup>13</sup>, këto prova rezultojnë të jenë marrë në vlerësim nga Komisioni. Po kështu, referuar konkluzionit të shprehur në pikën nr. 11.24 të vendimit<sup>14</sup>, rezulton se pavarësisht mungesës së referimit në vendim, shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti në seancë dëgjimore, janë shqyrtuar e vlerësuar, por ato nuk janë gjetur bindëse për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që ky pretendim ka për fokus zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga Komisioni. Pritshmëria e subjektit ishte që vlerësimi i provave nga ana e Komisionit të përputhej me kërkimin e saj. Është ky shkak për të cilin subjekti i rivlerësimit argumenton subjektivizëm dhe njëanshmëri kundrejt saj. Nga ana tjetër, fakti që subjekti i konsideron pretendimet e veta të mbështetura në provat e sjella, nuk nënkupton detyrim të Komisionit për të përfutur optikë të njëjtë me të. Komisioni ka diskrecion të vlerësojë në mënyrë të pavarur aktet dhe provat mbi bazën e dokumenteve dhe indicieve dhe ka një marzh bindjeje në vlerësimin që marrin aktet dhe provat, parë nën dritën e pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016<sup>15</sup> apo edhe nenit 81, të Kodit të Procedurës Administrative<sup>16</sup>. Optika e ndryshme e vlerësimit nga Komisioni, nuk nënkupton mungesë të analizimit dhe vlerësimit të provave dhe as subjektivizëm, por një analizë ndryshme që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimi i subjektit dhe në këtë kuptim, ky qëndrim ndryshe nuk e bën Komisionin as subjektiv dhe as të njëanshëm.

**11.8.** Sipas subjektit, Komisioni i ka ngarkuar asaj një barrë prove të paarsyeshme, jo propocionale e jo objektive, për gjetje “të rënda”, të cilat e “paravendosën” vendimmarjen. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e lidh me dy veprime njëri prej të cilëve për një investimin në pasuri të paluajtshme që ka rezultuar të jetë e një individi me të njëjtin emër e

---

<sup>13</sup> Kryesuesja ndër të tjera shprehet se “[...] Trupi gjykues dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike si dhe vlerësoi dokumentacionin shpjegues dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë përgjigjeve mbi rezultatet e hetimit si dhe ato të bëra prezent në seancën dëgjimore, vlerësoi shpjegimet dhe provat e depozituara me rezultatet e hetimit e ato të depozituara në seancë dëgjimore[...].”

<sup>14</sup> Në pikën 11.24 të vendimit Komisioni vlerëson se: “11.24. Në lidhje me njësinë e shërbimit zyrë, shuma 1.950.000 lekë, tërhequr cash nga llogaria e bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, e padeklaruar si transaksion dhe destinacion në vitin 2010 dhe shuma 17.000 euro derdhje nga bashkëshorti i subjektit në llogari të shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” sh.p.k. në datë 1.10.2012, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe pretendimi se ato nuk ishin transaksione të kryera nga bashkëshorti ngeli vetëm në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion ligjor provues.”

<sup>15</sup> Neni 49 pika 4 e ligjit nr.84/2016 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].”

<sup>16</sup> Neni 81 i K.Pr. Administrative parashikon: “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrativ [...].”

mblidhet me bashkëshortin e saj<sup>17</sup>. Subjekti argumenton se Komisioni është bazuar vetëm në një shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (referuar në vijim me shkurtimin DPPPP), për të ngritur dyshimin se është pasuri e fshehur, duke e ngarkuar atë padrejtësisht me barrë prove të paarsyeshme. Përpos vështirësive që ka hasur për administrimin e dokumentacionit, për shkak të ndalesave të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, depozitoi në seancë dëgjimore aktet<sup>18</sup> që provojnë se pagesat nuk janë kryer prej saj apo personave të lidhur me të. Sipas subjektit, Komisioni është kontradiktor, pasi ndonëse ka pranuar se pasuria në fjalë nuk është e subjektit, e ka pasqyruar këtë transaksion në analizën financiare të vitit 2012.

**11.9.** Ndërsa ky pretendim për aspektet e themelit gjen trajtim në shkakun ankimor përkatës, në kontekstin procedural, trupi gjyqësor i Kolegjit çmon të theksojë se transaksionet e kontestuara në ankim, janë raportuar nga DPPPP-ja dhe Banka Kombëtare Tregtare me shkresa të vitit 2017 si të kryera nga një individ me emër e mbiemër të njëjtë me bashkëshortin e subjektit. Po ashtu, Komisioni ka patur edhe të dhëna nga Ujështetësi Kavajë për kontratë lidhur për këtë pasuri në vitin 2013, nga një individ me të njëjtin emër e mbiemër. Për rrjedhojë, konstatimet paraprake të Komisionit që marrin shkas nga *tre* shkresa zyrtare, dhe me fokus pasuri të krijuar nga një individ me të njëjtat gjeneralitete si personi i lidhur me subjektin, nuk mund të argumentohen se janë barrë disproporcionale dhe e paarsyeshme.

**11.10.** Subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka njoftuar rezultatet e *prishme* të hetimit administrativ (krahas rezultateve të hetimit), në kundërshtim me parashikimet e nenit 87, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 44/2015. Komisioni duhet ta njoftonte nëse gjetja mund të çonte drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra apo të ndonjë mase tjetër, në mënyrë që subjekti të kishte mundësinë të ushtronte të drejtën për të provuar të kundërtën. Ky pretendim është i pabazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, pikën 6 të rregullores së funksionimit të Komisionit (Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjyqësore të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) dhe jurisprudencën e Kolegjit<sup>19</sup>, i cili tashmë ka konsoliduar qëndrimin se bazuar në ligjin nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit nuk kanë detyrim ligjor të rivlerësojnë situatën pas kalimit të barrës së provës e t’i bëjnë me dije subjektit një rezultat të dytë hetimi. Vlerësimet përfundimtare duhet të bëhen vetëm pasi subjekti i rivlerësimit paraqet argumentet dhe provat mbështetëse. Nëse Komisioni do të konkludonte që në fazën e hetimit se gjetja konkrete do të çonte drejt një mase disiplinore, atëherë ai do të paragjykonte çështjen, pasi me kalimin e barrës së provës subjektit, mund të ndodhte që me provat e sjella si gjatë hetimit, ashtu dhe në seancën dëgjimore, mund të përmbyseshin rezultatit paraprak i hetimit. Subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa pretendon, i është garantuar gjithashtu edhe e drejta për t’u mbrojtur, pasi informacioni që mori pas përfundimit të hetimit administrativ, i ka mundësuar asaj që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme. Asaj iu dha akses në dokumentacionin e çështjes dhe në metodologjinë e përdorur për kryerjen e analizës financiare,

<sup>17</sup> Një transfertë në shumën 1.950.000 lekë pranë Raiffeisen Bank, si edhe një derdhje në arkën e Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim BKT) të shumës 17.000 euro për blerjen e një vile në Malin e Robit, Qerret, Kavajë.

<sup>18</sup> Dy akte bankare dhe akti i ekspertimit grafik në lidhje me nënshkrimin në mandatpagesat e BKT-së.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 9(JR), datë 24.10.2018, paragrafi 54, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Xh..

në mënyrë që të përgatiste mbrojtjen<sup>20</sup>. Për gjithë sa më sipër, edhe ky pretendim rezultoi i pabazuar.

## ***B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë***

### ***B.2.1. Shkaqe të përgjithshme që lidhen me aspektin procedural e ligjor të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë***

12. Subjekti rendit disa argumente, me fokus aspekte ligjore, mbi kontrollin e pasurisë e konkretisht: (a) ajo nuk gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurive, pasi nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave; (b) konkluzionet përfundimtare të Komisionit, janë të gabuara pasi janë nxjerrë në një vlerësim jo të drejtë të shpjegimeve dhe provave të administruara gjatë këtij procesi; (c) vlera e pasurive në pronësi, justifikohet me të ardhurat e ligjshme të familjes së saj dhe nuk e kalon pragun e dyfishit të pasurisë së ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 i ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ligjore që aplikohet vetëm kur deklarimi i pamjaftueshëm vërtetohet në mënyrë kumulative për kriterin e pasurisë dhe kontrollin e figurës, nuk mund të gjejë zbatim në rastin e saj, pa iu nënshtruar kontrollit të dy kriterëve të tjera të vlerësimit, e për rrjedhojë, gjetjet e Komisionit nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

12.1. Shqyrtimi në themel i pretendimeve për vlerësimin e pasurisë shtjellohet në vijim të vendimit. Në këtë pjesë, përsa i përket kontekstit procedural e ligjor, përpos sa është arsytuar më sipër në hyrje të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit në raport me dispozitat ligjore të zbatueshme dhe gjendjen faktike që referojnë aktet, janë të pambështetura në ligj dhe në akte. Këtyre pretendimeve u janë dhënë përgjigje në mënyrë konsistente e të përsëritur nga Kolegji në vendime të mëparshme, për argumenta identike me ato të subjektit dhe kanë gjetur edhe elaborim të zgjeruar në vendimin kyç të GjEDNj-së Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Sa më sipër dhe pa u ndalur gjerësisht, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit për këtë aspekt, se leximi harmonik i neneve 61, pika 3, dhe neni 33, të ligjit nr. 84/2016, përcakton detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në zbatim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12.2. Pavarësisht se pika 3, e nenit 61, i ligjit nr. 84/2016 shprehet për të dyja kriteret, për shkak të drejtimit të qartë që Aneksi i Kushtetutës jep për secilin nga kriteret, nuk mund të argumentohet se deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë duhet të interpretohet në mënyrë kumulative, pra, domosdoshmërisht të kushtëzohet me probleme të kontrollit të figurës për të vërtetuar deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Këto kriteret nuk kërkojnë doemos praninë e njëra-tjetrës për tu vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm. Neni 61 parashikon gjashtë (6) rrethana ligjore të cilat janë autonome nga njëra-tjetra, dhe që passjellin në të njëjtën mënyrë, shkarkimin nëse vërtetohen. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim është i pambështetur në ligj.

---

<sup>20</sup> Qëndrim i mbajtur nga GjEDNj, në vendimin "Xhoxhaj kundër Shqipërisë", paragrafi 330, faqe 50.

## **B.2.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurive**

### **I. Pasuria apartament banimi, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë**

13. Komisioni ka ardhur në dijëni të kësaj pasurie *gjatë* hetimit administrativ<sup>21</sup>. As subjekti dhe as personat e lidhur *nuk* e kanë deklaruar atë në deklaratën *vetting*. Për të *parën herë*, kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2017, ku subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit, vlerën 90.720 euro dhe burimet e krijimit të saj e konkretisht: (i) kredi prej 9.000.000 lekësh marrë në 5 korrik 2017 nga i biri i subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank; (ii) kursime të familjes në shumën 1.300.000 lekë; si dhe (iii) hua me vlerë 14.000 euro marrë nga vëllai i saj (z. Sh. S.).

13.1. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte marrëdhënien me këtë pasuri, në zbatim të neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji. Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe as i pagesave të kryera apo i detyrimeve financiare të mbetura ndaj shoqërisë ndërtuese, u konsideruan përpjekje të subjektit dhe personave të lidhur me të, për të shmangur kontrollin e kësaj pasurie në bazë të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni ka konkluduar përfundimisht se në referencë të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm.

13.2. Në ankim, sikurse edhe në rezultatet e hetimit, subjekti potencon të njëjtat kundërshtime e argumenta me fokus kontestimin e konkluzionit të Komisionit se ajo ka pasur synim t’ia mënjanojë kontrollit këtë pasuri. Konkretisht subjekti potencon se nuk kishte detyrim për deklarim pasi nuk kishte të drejta reale mbi këtë pasuri. Aktmarrëveshja e përdorur si bazë për analizën e Komisionit ishte me objekt dhënien e kaparit, e nuk ka krijuar interesa pasurorë e të drejta reale për të. Aktet janë publike e të aksesueshme. Konstatimi i Komisionit se pasuria ka qenë në pronësi, posedim apo zotërim të familjes së saj, që në muajin shkurt të vitit 2016, është bazuar në një shkresë të pasaktë dhe të pavërtetë të Furnizuesit të Shërbimit Universal (në vijim referuar me shkurtime FShU). Provat e sjella prej saj për ndryshimin e emrit të abonentit të kontratës së furnizimit me energji elektrike nga shoqëria, në emër të bashkëshortit, më datë 05.11.2019, nuk janë konsideruar nga Komisioni. Ajo nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, pasi sikundër konstatuar nga Komisioni, subjekti ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e pagesave. Mosdeklarimi i akt marrëveshjes me shoqërinë ndërtuese në deklaratën për vitin 2016 mund të përbëjë pasaktësi në deklarim, por e pashoqëruar me pamjaftueshmëri financiare, ajo nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar jurisprudencës të konsoliduar të organeve të rivlerësimit.

13.3. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit përmbledhur më sipër nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti dhe

---

<sup>21</sup> Nga korrespondenca shkresore me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës është konfirmuar bashkëpronësia e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur (djali dhe bashkëshorti i sa) në apartamentin me sipërfaqe 95,60 m<sup>2</sup>, me vlerë 90.720 euro, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, lidhur në datën 16.06.2017, ndërmjet tyre dhe shitësit (shoqëria “{\*\*\*}” ShPK). Ndërsa Furnizuesi i Shërbimit Universal për Tiranën ka konfirmuar, ndër të tjera, edhe një kontratë furnizimi me energji elektrike për këtë pasuri, në emër të bashkëshortit të subjektit, hapur në datën 23.02.2016. Faturimi i kësaj kontrate ka filluar më datë 29.02.2016, dhe ka vijuar në muajt pasardhës.

personat e lidhur, ndodhen në kushtet e *deklarimit të pasaktë*, të kryer në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit u mbështet në problematikat që u evidentuan në lidhje me detyrimin e subjektit për deklarimin e kësaj pasurie, shtjelluar në vijim.

**13.4.** *Së pari*, nga aktet rezulton se gjatë hetimit administrativ<sup>22</sup>, subjekti ka shpjeguar se ky apartament është prenotuar nëpërmjet *akt marrëveshjes së datës 23.03.2016*. Çmimi i blerjes<sup>23</sup> do të paguhej brenda datës 23.03.2017, me të ardhurat e familjes, kursimet dhe një kredi bankare. Afati i likuidimit të çmimit u shty me tre muaj të tjerë, deri në datën 25.06.2017, pasi kredia bankare nuk u akordua brenda muajit mars 2017. Në pyetësin tjetër<sup>24</sup>, subjekti ka shpjeguar se në mars 2016, është materializuar aktmarrëveshja paraprake e datës 23.03.2016, me shoqërinë ndërtuese për prenotimin e një apartamenti. Marrëveshja ka qenë e kushtëzuar nga marrja e kredisë. Me kërkesë të shoqërisë ndërtuese, u pagua kapari prej 25.000 eurosh; çmimi total i apartamentit do të likuidohej brenda datës 25.03.2017. Në pritje të kreditimit, shumat e paguara gjatë vitit 2016 për llogari të kaparit “mbetën të ngurtësuara”, dhe për rrjedhojë, nuk ka deklaruar kontratën e porosisë apo që kjo shumë ishte gjendje. Pasi lëvrimi i kredisë bankare u premtua në fillim të vitit 2017, djali i saj dhe shoqëria ndërtuese nënshkruan, më datë 25.03.2017, një “Aneks Aktmarrëveshje”, përmes së cilës ranë dakord të zgjasin afatin e pagimit të çmimit të apartamentit deri në datë 25.06.2017. Kontrata e kredisë me Intesa Sanpaolo Bank u lidh më datë 07.07.2017, por në parim ishte dakordësuar me bankën që në fillim të muajit qershor 2017. Për rrjedhojë, më datë 16.06.2017, u lidh edhe kontrata e shitjes së apartamentit me rezervë pronësie. Deklarimi në deklaratën periodike për vitin 2017, ndodhi pasi kontrata e shitblerjes u finalizua në këtë vit.

**13.5.** Komisioni *nuk* ka kryer analizë të burimeve të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie dhe subjekti u ngarkua me barrë prove vetëm për mosdeklarimin në deklaratën *vetting*, të aktmarrëveshjes për blerjen e apartamentit, datë 23.03.2016, pagesave të kryera dhe detyrimeve të mbetura ndaj shoqërisë ndërtuese ({\*\*\*} ShPK) si dhe mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2016.

**13.6.** Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë porositur këtë pasuri në datën 23.03.2016, duke lidhur një aktmarrëveshje me shoqërinë ndërtuese. Po nga aktet<sup>25</sup>, rezulton se deri në mars 2017 subjekti dhe personat e lidhur me të, kishin *paguar* 25.000 euro, ose ekuivalentin e mbi ¼ e çmimit total të kësaj pasurie. Nga kjo shumë, sipas mandatarkëtimeve përkatëse<sup>26</sup> dhe ato të mbetura, 14.300 euro janë likuiduar kundrejt

---

<sup>22</sup> Në përgjigje të pyetësit nr. 1.

<sup>23</sup> Sipas akt marrëveshjes, e gjithë shuma prej 90.720 euro do të likuidohej brenda datës 23.03.2017. Për të garantuar shitblerjen, porositësi E. O. duhej të paguante në formën e kaparit në arkën e shoqërisë, shumën prej 25.000 euro, qoftë edhe me këste, deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të porosisë.

<sup>24</sup> Në përgjigje të pyetësit nr. 2.

<sup>25</sup> Në aneks marrëveshjen të lidhur në vijim të aktmarrëveshjes, datë 23.03.2016, palët kanë konfirmuar se deri në datën e hartimit të këtij aneksi (datë 25.03.2017), porositësi ka likuiduar me këste të ndryshme shumën 25.000 euro, sipas mandatarkëtimeve që i bashkëlidhen këtij akti.

<sup>26</sup> Mandatarkëtimet: nr. {\*\*\*}, datë 25.03.2016, me vlerë 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 25.05.2016, me vlerë 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 12.09.2016, për këstin 2000 euro; nr. {\*\*\*}, datë 15.11.2016, me vlerë 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 15.01.2017, për këstin 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 25.01.2017, me vlerë 2300 euro; nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2017, për pagesën 2000 euro; nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2017, me vlerë 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 27.02.2017, me vlerë 2500 euro; nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2017, për këstin 1500 euro dhe nr. {\*\*\*}, datë 25.03.2017, për likuidimin e shumës 2200 euro.

shoqërisë së ndërtimit *përpara* se të depozitohet deklarata *vetting* (në 26 janar 2017), ndërsa deri në momentin kur subjekti ka dorëzuar deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, ishte paguar pjesa tjetër e diferencës së vlerës prej 25.000 eurosh. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* apo atë *periodike* për vitin 2016, asnjë nga këto veprime, sikurse as detyrimet e shlyera gjatë vitit 2016. E thënë ndryshe, subjekti ka hyrë në një marrëdhënie juridike dhe detyrimi, duke kryer edhe pagesa. Të gjitha këto fakte juridike nuk janë deklaruar deri në mars të vitit 2018, me deklaratën periodike të vitit 2017.

**13.7.** Nën dritën e sa më sipër, pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Subjekti është përpjekur ta përshkruajë situatën në një mënyrë alternative me faktet, nëpërmjet të cilës duke i dhënë fokus vetëm finalizimit të përfitimit të pasurisë, anashkalohen gjithë veprimet e tjera të kryera dhe pagesat e shlyera, aspekte të cilat i nënshtroheshin kontrollit të pasurisë qoftë për shkak të rivlerësimit, ashtu edhe për efekt të ligjit nr. 9049/2003, në zbatim të të cilit, ajo deklaroi pasurinë që prej vitit 2003, së bashku me personin e lidhur/bashkëshortin. Konkretisht, në pikën 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nenin 31, të ligjit nr. 84/2016 e Shtojcën 2 dhe Udhëzimin<sup>27</sup> të ILDKPKI-së nr. 4095/2016, dalë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mbante detyrimin për të deklaruar në deklaratën *vetting* pasuritë e paluajtshme, pavarësisht nëse ishin të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, duke e shoqëruar edhe me dokumentacionin justifikues ligjor, përfshirë kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrjeje, *akt marrëveshje*, kontratë paraprake, kontratë porosie. Po ashtu, ligji nr. 9049/2003 i ndryshuar, ngarkon subjektet me detyrimin për të deklaruar jo vetëm të drejtat pronësore apo reale, por edhe *detyrimet financiare* ndaj personave juridikë dhe fizikë, në kuptim të shkronjës “dh”, të nenit 4 të tij.

**13.8.** Pretendimet e subjektit se shumat e paguara deri në fund të vitit 2016 për llogari të kësaj pasurie, mbetën të ngurtësuar apo janë deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, janë të pakuptimta. *Së pari*, për sa kohë këto fonde janë paguar/kanë dalë nga ekonomia e saj familjare, pretendimi i subjektit për efektin që ato kanë në raport me shitësin e pasurisë – si fonde të ngurtësuar – nuk përkon me kërkesën e ligjit për të deklaruar shpenzimet dhe detyrimet. Ky argument do të bënte kuptim nëse në diskutim do të ishte konteksti civil i marrëdhënies juridike. Në kushtet që kontrolli i pasurive qoftë në rivlerësim apo edhe në deklaratat periodike përfshin detyrimet financiare të përmbushura dhe ato të pa shlyera, kjo qasje është e pakuptimtë. Për të njëjtën arsye, edhe pretendimi se fondet në fjalë janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit është i pakuptimtë, pasi një shumë e paguar si pjesë e një detyrimi, nuk mund të jetë “gjendje” në *cash* në kushtet që përkufizimisht nuk është më gjendje e likuiditeteve të subjektit por i ka kaluar shitësit. Pagesa e kryer shoqërisë ndërtuese, nuk ka gjetur pasqyrim në asnjë formë, përfshirë si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, kursime, apo në depozitë bankare. Ky konstatim qëndron edhe duke abstraguuar nga problematika e rrethanave faktike të sipërkonstatuara lidhur me mungesën e deklaramit të këtij shpenzimi dhe të ndërmarrjes së hapave për krijimin e një pasurie.

---

<sup>27</sup> “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13.9. Nga ana tjetër, ndonëse Komisioni ka referuar kohën kur është lidhur kontrata e shërbimeve utilitare<sup>28</sup> në shkurt 2016, ky element që shërben si indicie për momentin kohor të vënies në posedim të apartamentit nuk është shoqëruar me asnjë pasojë për subjektin. Komisioni nuk e ka ngarkuar atë me barrë prove për të provuar kur ka nisur përdorimi i apartamentit. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për të mos i dhënë vlerë provuese akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, lidhur me kohën kur bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratën e energjisë, nuk ka asnjë peshë e as relevancë për t'iu nënshtuar verifikimit të mëtejshëm në Kolegj.

13.10. *Së fundmi*, por jo nga rëndësia, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se pretendimet e subjektit janë jo bindëse pasi mënyra sesi ajo ka deklaruar pasurinë tjetër njësi shërbimi (shtjelluar në vijim), tregon qartësinë e saj për detyrimin ligjor për deklarim të pasurive të porositura dhe detyrimeve financiare të shlyera e në *proces shlyerje* duke filluar nga viti 2010, pavarësisht nga fakti që shitja përfundimtare u krye në vitin 2013. Në *ndryshim* nga ajo pasuri, për apartamentin objekt analize, subjekti e lidh detyrimin për deklarim me momentin ligjor të kalimit të pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Edhe parë në këtë këndvështrim, pretendimi i subjektit se flitet për një pakujdesi, është jobindës. Mbi të gjitha, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon që në kushtet që edhe vetë subjekti e paraqet mosdeklarimin si pakujdesi, ndërsa Komisioni nuk ka konkluduar për fshehje, por është kufizuar në pasaktësi në deklarim, pretendimet e subjektit janë pa relevancë.

13.11. Në raport me kuadrin ligjor të sipërreferuar, ku subjekteve u kërkohet deklarimi me *saktësi* dhe *vërtetësi* i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, për subjektin dhe personat e lidhur të tyre, harresa apo ndonjë formë tjetër *pakujdesie* në plotësimin e një formulari, kontrolli i të cilit mund të afektojë vazhdimësinë e karrierës të subjekteve të rivlerësimit, nuk mund të argumentohet se përligjet në nivelin që të mos përbëjë as pasaktësi në deklarim, që në thelb ka përbërë një qasje tejet *favorizuese* për subjektin duke mbajtur në konsideratë gjithë rrethanat konkrete. Për këto arsye, konstatimi i Komisionit në lidhje me mosdeklarimin në DIPP 2016 dhe atë *vetting*, të aktmarrëveshjes, datë 23.03.2016, për blerjen e apartamentit, si dhe të drejtave e detyrimeve të rrjedhura prej saj, është konstatim i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në akte.

13.12. As pretendimi i subjektit se nuk ka pasur qëllim fshehjen pasi ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme, nuk mbështetet në akte. Përkundrazi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në vazhdë të qëndrimit favorizues për subjektin, Komisioni *nuk* ka kryer analizë financiare të mundësive financiare me burime të ligjshme për pagesat e kryera për këtë pasuri, dhe as i ka kaluar asaj barrë prove, ndonëse një pjesë e pasurisë është paguar përpara plotësimin të deklaratës *vetting*. Konkretisht, në faqen 32 të rezultateve të hetimit, Komisioni është shprehur tekstualisht se *nuk* ka kryer analizë të burimeve të të ardhurave për këtë pasuri<sup>29</sup>. Mungon tërësisht arsyetimi për shkaqet për të cilat është zgjedhur

<sup>28</sup> *Data e lidhjes së kontratës së energjisë elektrike, sipas konfirmimit të FShU-së.*

<sup>29</sup> *Në faqen nr. 32 të rezultateve të hetimit, Komisioni shprehet tekstualisht: "[...] Komisioni, pasi analizoi provat, deklaratimet e subjektit në pyetësore, pa i hyrë analizës së burimeve të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, vlerësoi faktin se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në Deklaratën vetting dhe në deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2016, duke shkelur detyrimet e përcaktuara nga ligji nr. 84/2016 si dhe ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë", i ndryshuar, neni 4, ndonëse ka pasur një Aktmarrëveshje me shoqërinë e ndërtimit {\*\*\*} shpk, datë 23.03.2016, për blerjen e këtij apartamenti [...]"*

kjo qasje, pavarësisht se vlera në fjalë është paguar gjatë periudhës së rivlerësimit e daton nga marsi 2016 deri në janar 2017, përpara deklaratës *vetting*. Në këto kushte, për shkak të garancive procedurale që gëzon subjekti në ankim, trupi gjykues i Kolegji konfirmon vetëm konstatimin e deklaratës të pasaktë për këtë pasuri, në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. Apartamenti në Bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë dhe apartamenti në Plazh, Durrës**

14. Për të dyja këto pasuri të deklaruara në deklaratën *vetting*, Komisioni vlerësoi përfundimisht, se subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, parashikuar nga germa “d”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka shqyrtuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë ndërtuese të dy pasurive të paluajtshme (subjekti “{\*\*\*}” ShPK) apo përfaqësuesin e saj ligjor.

14.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit duke potencuar se detyrimet ndaj shoqërisë kanë përfunduar me marrjen në posedim të pasurive. Legjislacioni për ndalimin e konfliktit të interesit nuk mund të gjejë zbatim në ngjarjet në fjalë, pasi ka hyrë në fuqi pasi janë krijuar pasuritë. Subjekti po ashtu argumenton se nuk gjendet në situatë konflikti i interesit as në kuptim të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile, pasi ka respektuar të drejtat e detyrimit e gjyqtarit dhe ka paraqitur kërkesa heqje dorë nga gjykimi i çështjeve ku ishte palë personi juridik në fjalë. Në kushtet që kërkesat nuk janë pranuar, ka vijuar gjykimin. *Së fundmi*, subjekti potencon se në kushtet që Komisioni nuk ka vlerësuar kriterin profesional për të dhe konflikti i interesit është komponent i vlerësimit profesional, ky konkluzion është i padrejtë dhe i pa mbështetur në ligj.

14.2. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të *pabazuar* konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e konfliktit të interesit në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore me palë përfaqësuesin ligjor apo shoqërinë ndërtuese/shitëse të dy pasurive të marra në analizë. Konkluzioni i Komisionit lidhet me dy apartamente të blera prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nga kjo shoqëri ndërtuese, në qendër të Tiranës dhe në plazh në Durrës, përkatësisht me sipërfaqe 147 m<sup>2</sup> dhe 80 m<sup>2</sup>, në vitet 2002 dhe 2003. Apartamentet, sipas akteve, referohen 6.4 milionë lekë e 1600 USD njëri, dhe 32 mijë USD tjetri. Komisioni nuk ka kryer asnjë analizë financiare për mundësinë e krijimit të këtyre dy pasurive me burime të ligjshme, qoftë edhe ngushtësisht në kontekstin e ndonjë trajtimi preferencial. Për rrjedhojë, konkluzioni për konflikt i interesit në kuadër të vlerësimit pasuror, sipas nenit 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, është i pakuptimtë e sfidon logjikën. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

14.3. Konkretisht, rezulton se në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove si vijon: “(i) *Ka mospërputhje midis kontratës së sipërmarrjes të lidhur nga subjekti me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}”shpk dhe kontratës së sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” nga personi i lidhur, në lidhje me shumën e paguar, kohën e pagesës të çmimit të blerjes për pasurinë apartament banimi 3+1; (ii) Aneks kontrata e porosisë, datë 18.07.2003, është bërë me qëllim për përfitimin e shtesës së kredisë në shumën 2.500.000 lekë. (iii) Subjekti dhe personi i lidhur, kanë lidhur disa kontrata porosie me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK për porositjen e kesaj pasurie në {\*\*\*}, Tiranë. Sjellja e subjektit në këtë rast duke lidhur*

kontratë porosie, me mbiemrin e vajzërisë dhe me çmim të ndryshëm nga kontrata e lidhur nga bashkëshorti i saj, përbëjnë veprime të cilat cenojnë besimin e publikut te drejtësia. (iv) Subjekti ka mungesë të dokumentacionit provues për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme nga aktiviteti privat si avokate dhe notere për periudhën Janar 1994 - 30.12.1999, në qytetin e Peshkopisë. (v) Subjekti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në disa vendimarrje me palë shoqëria “{\*\*\*}” shpk, apo përfaqësuesit ligjor të kësaj shoqërie, parashikuar nga neni 33, pika 5, gërma “d” e ligjit nr. 84/2016. (vi) Subjekti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin dhe vendimarrjen e çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShA.”

**14.4.** Së pari, nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të nënvizojë se në vendim, Komisioni ka lënë në heshtje gjetjet e sipërcituara në rezultatet e hetimit, duke zgjedhur të ndalet vetëm mbi njërin aspekt, konfliktin e interesit. Konkretisht, Komisioni nuk ka qëndrim të vetin për sa ka rezultuar, pasi subjekti ka prapësuar rezultatet e hetimit administrativ, duke krijuar kështu një vakuum arsytimi dhe një qëndrim tejet favorizues për subjektin në kontrollin e pasurisë. Për rrjedhojë subjekti ka ankimuar<sup>30</sup>, vetëm konfliktin e interesit, për të cilën është ngarkuar me përgjegjësi. Kjo rrethanë paraqet rëndësi për trupin gjykues, në kushtet që *konflikt interesi* në kushtet e gërmës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, përbën identifikim të gabuar të ligjit nr. 9367/2005.

**14.5.** Po ashtu, Komisioni nuk ka kryer asnjë analizë as edhe për natyrën e marrëdhënies së subjektit e personit të lidhur me ortakun/administratorin e shoqërisë ndërtuese, z. Rr. H.. Ky i fundit, që nga viti 2002, rezulton të ketë qenë edhe garantor, nëpërmjet një pasurie personale të tij, për një kredi të marrë nga bashkëshorti i subjektit, që vijonte edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*<sup>31</sup>. Referuar deklaratës *vetting*, kredia pagohej pranë Raiffeisen Bank, pas transferimit me VKM nr. 830/2014.

**14.6.** Së fundmi, nga aktet ka rezultuar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se detyrimet ndaj shoqërisë janë përmbushur që në momentin e marrjes në posedim të këtyre pasurive, apo që nuk kanë pasur detyrime të pashlyera, është i pavërtetë për apartamentin në Tiranë. Shlyerja

---

<sup>30</sup> Në pikën nr. 46 të ankimit, subjekti shprehet: “[...]në përmbajtje të vendimit, nuk arsyetohet në lidhje me problematikat e paraqitura në materialin e hetimit administrativ, të cilat duke mos qenë pjesë e përfundimeve të Komisionit në lidhje me vendimarrjen, presupozohet të jenë sgaruar”. Më tej, në pikën 84 të ankimit, subjekti shprehet: “Në Vendimin nr. 525, datë 27.04.2022, nuk është arsyetuar nëse unë dhe familja ime kemi pasur mundësi të krijojmë me të ardhura të ligjshme, pasuritë e paluajtshme, [...] Për krijimin e këtyre dy pasurive, në përfundim të hetimit administrativ, referuar dhe konkluzioneve në vendimin objekt i këtij ankimi, nuk ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare e burime të ardhurash”.

<sup>31</sup> Në datën 19.06.2002, bashkëshorti i subjektit ka aplikuar për një kredi bankare prej 2.5 milion lekësh, për zgjerim, sipas VKM nr. 102/1999. Për përmbushjen e kësaj kredie ka dalë garant z. Rr. H., përfaqësuesi ligjor dhe ortak i vetëm i {\*\*\*} ShPK, i cili me deklaratën noteriale, datë 10.01.2002, ka dhënë miratimin për vendosjen e hipotekës mbi një apartament banimi dy dhoma e kuzhinë, në pronësi të tij. Shuma 2.5 milion lekë e akorduar nga banka, më datë 03.07.2002, u transferua në favor të firmës “{\*\*\*}” ShPK/Rr. H., me përshkrimin që referon kontratën e parë e sipërmarrjes së apartamentit që mban datën 18.06.2002 dhe VKM nr. 102/1999. Pas një viti, në datën 05.06.2003, bashkëshorti i subjektit i është drejtuar sërish Degës së Bankës së Kursimeve për vazhdimin e procedurave të kredisë prej 2.500.000 lekësh. Për përmbushjen e kësaj shtese kredie ka dalë sërish garant Rr. H., i cili ka lëshuar edhe një deklaratë të re noteriale më datë 27.07.2003, për të dhënë miratimin që apartamenti i hipotekuar në favor të bankës si garanci për përmbushjen e kredisë së parë, të rivendosej në garanci edhe për shtesën e kredisë. Shtesa e kredisë në shumën 2.500.000 lekë është miratuar nga Banka e Kursimeve me vendimin datë 31.07.2003, e cila ka lidhur kontratën noteriale të huas/kredisë datë 06.11.2003 me të njëjtat palë e mbi të njëjtën bazë ligjore. Në vijim, është lidhur edhe kontrata e re noteriale e dorëzarisë, më datë 06.11.2003, me të njëjtin dorëzues e të njëjtin objekt.

e detyrimeve financiare ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për këtë pasuri, ka vijuar *edhe pas* vitit 2002<sup>32</sup> të vënies në posedim sipas deklaratës *vetting*.

**14.7.** Konkluzioni i vetëm i Komisionit, cilësuar *konflikt interesi* në kushtet e germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, përbën identifikim të gabuar të ligjit nr. 9367/2005 pasi, tre (3) nga katër (4) vendimet gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit datojnë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji<sup>33</sup>. Në rrethanat konkrete, trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza ligjore mund të ishte orientuar vetëm drejt dispozitave procedurale civile të kohës, dhe jo një kuadri ligjor që nuk ekzistonte ende në kohën e vendimmarjes. *Së dyti*, dhe ç’është më e rëndësishmja, Komisioni nuk ka hetuar për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin, në mënyrë që të orientohej analiza drejt etikës dhe integritetit të subjektit, në kushtet që ka shqyrtuar çështje ku palë është një person me të cilin ajo ka marrëdhënie interesi në vazhdim.

**14.8.** Për sa më sipër, dhe në kushtet që Komisioni nuk ka konkluzion në vendim për aspektet e analizës financiare të krijimit të këtyre dy pasurive, të cilat bashkërisht kanë një vlerë të konsiderueshme financiare, sikurse as edhe për problematika të tjera për të cilat i ka kaluar barrë prove fillimisht subjektit, aplikimi i nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, që qartazi parashikohet si një ndër normat që gjejnë zbatim në kriterin e vlerësimit të pasurisë, është një qasje e pakuptimtë dhe e paarsyetuar. Konkluzioni i Komisionit do të qëndronte teorikisht vetëm si pasojë e një analize nga e cila do të rezultonte përfitim i një pasurie nëpërmjet veprimtarisë në kushtet e konfliktit të interesit, në kontekstin e vlerësimit pasuror.

**14.9.** Duke qenë se procesi i rivlerësimit nuk është kryer për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni nuk ka kryer hetime nëse vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit për këto çështje gjyqësore, është ose jo në përputhje me ligjin material e atë procedural. I vetmi vendim gjyqësor që daton pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9367/2005, është ai me nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2005, me palë paditëse R. H., i paditur {\*\*\*} ShA, dhe objekt anulim fature shërbimi. Edhe për këtë çështje, vërehet mungesë arsytimi nga ana e Komisionit në raport me atë që parashikohet në këtë ligj për konfliktin e interesit. Për rrjedhojë, ka mbetur pa u verifikuar nëse subjekti ka kryer në përputhje me ligjin detyrën, e për rrjedhojë, edhe nëse interesi privat i subjektit ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive zyrtare<sup>34</sup>. Duke abstraguuar nga pyetja nëse vendimi i marrë nga gjyqtarja/subjekti ka qenë i drejtë ose jo, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se pa i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme, nuk mund të shkohet drejt konkluzionit se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka qenë i padrejtë pikërisht dhe vetëm për shkak të ndikimit negativisht të interesit privat të subjektit, e për rrjedhojë, nuk mund të prezumohet se subjekti

---

<sup>32</sup> *Kësti i tretë në shumën 2.500.000 lekë, i përcaktuar në Aneksin e Kontratës së Sipërmarrjes {\*\*\*}, datë 15.07.2003, është likuiduar, më datë 12 nëntor 2003, referuar urdhërpagesës, datë 12 nëntor 2003, me porositet K. O. e përfitues {\*\*\*} ShPK me përshkrimin “sa likuiduar me kredi sipas kontratës {\*\*\*}, datë 15.07.2003”; (iv) diferenca e mbetur në shumën 1.400.000, e cila sipas Aneksit të Kontratës së Sipërmarrjes {\*\*\*}, datë 15.07.2003, do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit nga shitësi, nuk rezulton e dokumentuar, por rezulton e likuiduar referuar deklaratës, datë 08.06.2017, të presidentit të z. Rr. H..*

<sup>33</sup> *Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, ka hyrë në fuqi 15 ditë, pas publikimit të tij në fletoren zyrtare nr. 31, datë 11.05.2005, ndërsa vendimet e gjykatës janë të datave 02.04.2003, 29.03.2002 dhe 17.04.2002.*

<sup>34</sup> *Në ligjin nr. 9367/2005, e konkretisht në pikën 1, të nenit 3, konflikti i interesit përkufizohet si “gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike”.*

i rivlerësimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit *për efekt të ligjit nr. 9367/2005* në fuqi në këtë periudhë. Në përfundim, ky konkluzion i Komisionit është i pabazuar e nuk mund të përfshihet ndër aspektet mbi të cilat bazohet vendimi i trupit gjykues të Kolegjit.

**14.10.** Konstatimi i mësipërm shihet i nevojshëm edhe në funksion të pretendimeve të subjektit se Komisioni ka paravendosur vendimmarrjen, apo se vendimi ka mungesë arsytimi. Përpos sa është konstatuar më sipër për pasurinë e parë të analizuar, për të cilën Komisioni nuk ka kryer asnjë analizë financiare, edhe në këto pasuri Komisioni ka treguar një qasje veçanërisht favorizuese për subjektin. Sikurse shtjellohet në vijim, trupi gjykues i Kolegjit vëren një qasje të dyfishtë të subjektit në raport me aspektin e arsytimit të vendimit objekt shqyrtimi. Konkretisht, subjekti ka zgjedhur të potencojë mungesë arsytimi vetëm mbi ato çështje të cilat nuk janë vlerësuar nga Komisioni sipas pritshmërisë së saj, ndërsa mungesën e arsytimit për këto dy pasuri që ka krijuar favorizim për të (sipas konstatimit në Kolegj), e konsideron si pranim të shpjegimeve të dhëna pas kalimit të barrës së provës.

**14.11.** *Së fundmi*, në përmbledhje të këtij arsytimi dhe nën dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit e çmon të panevojshme të ndalet më tej në analizën e këtyre pasurive, në kushtet që aspektet me natyrë pasurore të tyre nuk janë shkak ankimi dhe as kanë përbërë shkak për masën disiplinore.

### **III. Pasuria njësi shërbimi ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë**

15. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë e saj dhe të bashkëshortit mbi këtë pasuri, me sipërfaqe 43,81 m<sup>2</sup>, regjistruar më datë 05.03.2013. Subjekti ka deklaruar se vlera e pasurisë është 52.572 euro dhe që është krijuar me kursimet e familjes në vite. Për herë të parë, kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2010. Në deklarimin për atë vit, subjekti dhe bashkëshorti veçmas kanë deklaruar porositjen e njësisë dhe pagesën e një kësti prej 8.000 eurosh por jo vlerën e pasurisë. Në vitet në vijim, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar edhe këstet përkatëse të paguara<sup>35</sup>. Në deklaratën për vitin 2015 është deklaruar pagesa e këstit 10.000 euro dhe që detyrimi është likuiduar plotësisht.

**15.1.** Komisioni ka konkluduar se subjekti ka *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri dhe se ka bërë deklaram *të pasaktë*. Për rrjedhojë, subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të po këtij ligji. Ky vlerësim është bazuar në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, kanë mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar: (i) pagesën e këstit *të parë* të pasurisë duke rezultuar me një balancë negative në vitin 2010, në vlerën 1.003.580 lekë; (ii) pagesën e kësteve të tjerë deri në vitin 2013, duke rezultuar me diferencë negative për vitin 2012 në vlerën 1.357.110 lekë dhe në vitin 2013 në vlerën 2.898.089 lekë. Komisioni po ashtu ka konkluduar se vlera e deklaruar në deklaratën *vetting* nuk është ajo e dakordësuar prej palëve në kontratën e shitblerjes të datës 08.02.2013.

<sup>35</sup> Përkatësisht, në deklaratat për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar pagesën e kësteve prej 10.000 eurosh, dhe shumën e mbetur prej 32.000 eurosh, 7.575 eurosh, dhe mandatpagesën nr. {\*\*\*} datë 04.05.2012, 5.000 euro me mandatpagesë (pa specifikuar numër dhe datë) e po ashtu edhe detyrimin e mbetur 6.002 euro dhe mandatin e arkëtimit 08.02.2013 [bashkëshorti] dhe së fundmi, 11.997 euro dhe detyrimin e mbetur 10.000 euro.

**15.2.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e sipër-referuar, duke pretenduar se familja e saj ka disponuar të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë në fjalë dhe konteston çmimin mbi të cilin është kryer analiza. Çmimi më i lartë në kontratën e shitjes të vitit 2013, ishte gabim i shoqërisë ndërtuese, i cili u saktësua nëpërmjet *akt-rakordimit* të datës 03.02.2014. Çmimi dhe mënyra e pagimit të deklaruar prej saj në deklaratën *vetting* përputhet me kontratën e porosisë dhe me deklaratimet periodike vjetore. Pagesat janë kryer sipas kontratës. Në vitin 2016 kur është deklaruar kjo pasuri, ishte likuiduar tërësisht çmimi i blerjes, sipas mandatpagesave që kanë fuqi të plotë provuese. Subjekti konteston edhe mënyrën sesi Komisioni ka vlerësuar provat, duke kërkuar që të njihen edhe mandatarkëtimet e depozituara prej saj për vitet 2014 dhe 2015, si me të njëjtën vlerë provuese me ato të viteve 2010 – 2013, të cilat janë pranuar nga Komisioni. Mandatpagesat janë në përputhje me ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Subjekti konteston edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2010 – 2015 për zëra të ndryshëm.

**15.3.** Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit nën dritën e dispozitiveve ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë *mungesë* burimesh të ligjshme për krjimin e kësaj pasurie, dhe kanë kryer deklaratim *të pasaktë*, parashikuar nga pikat 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe neni 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim trupi gjykues mbajti në konsideratë qoftë kontradiktat në deklaratimet e subjektit sa i përket *çmimit* të blerjes së kësaj pasurie dhe mënyrës e periudhave të likuidimit, të cilat krijojnë probleme për besueshmërinë e pretendimeve të saj, sikurse edhe pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme të disponuara prej saj dhe personit të lidhur, në funksion të krijimit të kësaj pasurie. Pretendimet që u vlerësuan të bazuara, nuk ishin të mjaftueshme për të ndryshuar këtë konkluzion. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**15.4.** Trupi gjykues e mbështeti analizën e kryer për pasurinë objekt vlerësimi, në çmimin e përcaktuar nga palët në *kontratën* e shitjes, për shkak të vlerës provuese që ajo paraqet sipas ligjit, dhe në linjë me arsyetimet e konsoliduara të Kolegjit në çështje të mëparshme, nën dritën e kriterëve të nenit 49, pika 4 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit për të përlllogaritur një vlerë më të ulët sesa ajo e kontratës së shitjes, bazuar në një shkresë të thjeshtë si kontrata *jo noteriale* e porosisë, u vlerësuan nga trupi gjykues si përpjekje për të përmbysur situatën negative financiare të burimeve të ligjshme.

**15.5.** Mospërputhjet e ndryshme mes akteve, u vlerësuan në drejtim të besueshmërisë së rrethanave të pretenduara nga subjekti për çmimin dhe mënyrën e pagesës. Probleme të besueshmërisë së kontratës së porosisë rezultojnë edhe në raport me provat e tjera sikurse deklaratat periodike vjetore, madje edhe me vetë mandatarkëtimet.

**15.6.** *Së fundmi*, shkresa e titulluar “akt - rakordimi” po ashtu u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit e pabesueshme, në kushtet që bie ndesh me parashikimet ligjore për korrigjimin e akteve në veprimet noteriale, të cilat kërkojnë prezencën e noterit. Me fjalë të tjera, edhe në një variant hipotetik të ekzistencës së një gabimi thelbësor në kontratën noteriale të vitit 2013, nëpërmjet të cilës është kryer shit-blerja e pasurisë objekt analize, sikurse edhe çmimi, si një ndër elementet thelbësore të saj, korrigjimi i gabimit do të duhet të ishte bërë nëpërmjet një

akti noterial. Akti në fjalë, nëpërmjet të cilit subjekti kërkon të përlllogaritet një çmim i reduktuar/më i ulët i pasurisë, është kryer nga palët, si një shkresë e thjeshtë e nënshkruar prej tyre.

**15.7.** Sa i përket mënyrës së likuidimit të këstit të parë, në vitin 2010, trupi gjykues çmon se kontrata e porosisë e vitit 2010, vlerësuar qoftë sipas dispozitave materiale civile për interpretimin e kontratave (nenet 681 - 689 të Kodit Civil), ashtu edhe në raport me deklaratën periodike për vitin 2010 ku subjekti ka deklaruar një këst të vetëm prej 8.000 eurosh, morën peshë provuese kundrejt pretendimeve të subjektit në proces për likuidimin e kësaj shume pjesë - pjesë.

**15.8.** Trupi gjykues i Kolegjit, çmon të theksojë në drejtim të mungesës së besueshmërisë së deklaratimeve të subjektit, edhe pretendimet për shumën prej 1.950.000 lekësh depozituar dhe tërhequr prej personit të lidhur/bashkëshortit në datën 28.06.2010 në një bankë të nivelit të dytë (Raiffeisen Bank). Sipas subjektit, këto veprime janë gabime të kryera nga punonjësit e bankës. Duke mbajtur në konsideratë që gjeneralitetet identifikuese të veprimeve bankare pasqyrojnë saktësisht të dhënat e identitetit të personit të lidhur me të/bashkëshortit, e konkretisht numrin e kartës së identitetit të tij, ndonëse gabimisht referuar si numër pasaporte, si dhe faktin që pretendimi për gabim mbeti deklarativ, ky depozitim u përfshi në analizën financiare për vitin përkatës. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit, rezultoi edhe në Kolegji se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë patur mundësi të depozitojnë këtë vlerë në datën 28.06.2010. Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të padrejtë vlerësimin e Komisionit për të pasqyruar këtë vlerë si shpenzim në analizën financiare, pasi nuk pasqyron situatën faktike të shpenzimeve të kryera.

*a. Analiza e pretendimeve me fokus çmimin e pasurisë dhe mënyrën e likuidimit*

**15.9.** Nga aktet e sipër-referuara, rezulton se vlera prej 52.572 euro e pasurisë është deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*. Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar pagesat e kryera ndër vite, të cilat në total janë në shumën që përkon me vlerën e deklaruar në deklaratën *vetting*. Me deklaratën *vetting*, subjekti ka dorëzuar kontratën e porosisë<sup>36</sup> datë 10.05.2010, me anë të së cilës bashkëshorti i saj ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse [{"\*\*\*"} ShPK], dyqan me sipërfaqe totale 48.45 m<sup>2</sup>. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 52.572 euro. Nga ky çmim, palët kanë rënë dakord që të likuidohej shuma 8.000 euro, ndërsa diferenca do të likuidohej me këste. Afati i dorëzimit të objektit është data 31.12.2010. Në dokumentacionin e përcjellë nga AShK-ja, nga ana tjetër, ndodhet kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme<sup>37</sup> datë 08.02.2013. Sipas këtij akti, pasuria është shitur kundrejt çmimit 61.334 euro. Po ashtu, FShU-ja ka evidentuar që kontrata e furnizimit me energji elektrike për pasurinë objekt shqyrtimi është hapur në emër të bashkëshortit të subjektit në datën 14.11.2007.

**15.10.** Gjatë hetimit administrativ<sup>38</sup>, dhe gjatë kontrollit në ILDKPKI në vitin 2015, subjekti ka pretenduar se mospërputhja mes kontratës së shitjes dhe asaj të porosisë për çmimin, është për shkak të një *gabimi çmimi* në kontratën e shitjes për shumën prej 61.334 eurosh. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar dy kontratat e mësipërme si edhe një dokument të

<sup>36</sup> Kontratë jo noteriale, me vulë të shoqërisë [{"\*\*\*"}] ShPK.

<sup>37</sup> Nr. [{"\*\*\*"}] rep., nr. [{"\*\*\*"}] kol., datë 08.02.2013.

<sup>38</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

thjeshtë të titulluar “akt-rakordimi”<sup>39</sup> që mban datën 03.02.2014, ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë në fjalë. Sipas këtij akti, deri në vitin 2013 ishte shlyer shuma 30.575 euro<sup>40</sup>. Nga shuma e mbetur prej 21.997 eurosh, shuma 11.997 euro do të likuidohej gjatë vitit 2014, ndërsa 10.000 euro gjatë vitit 2015.

**15.11.** Komisioni ka konsideruar si provë të besueshme dhe si akt me fuqi të plotë provuese, vetëm kontratën e shitblerjes, në referim të nenit 49, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, nenit 253, të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1 datë 06.01.2009. Nga ana tjetër, mandatpagesat e thjeshta, të depozituara me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, u vlerësuan të parregullta dhe të lëshuara në kundërshtim me dispozitat për kontabilitetin. Komisioni përlllogariti çmimin e blerjes 61.334 euro, sipas kontratës së shitblerjes dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme, dhe jo 52.572 euro, sipas kontratës së porosisë dhe akt-rakordimit. Në analizën financiare, çmimi prej 61.334 eurosh është përfshirë i ndarë në vite, sipas kalendarit që rezulton nga kontrata e porosisë dhe deklaratës periodike për vitin 2010, e deklaratave periodike vjetore për periudhën në vijim. Mbi këtë qasje, Komisioni ka përlllogaritur 8.000 euro të shlyer në datën 10.05.2010, ndërsa në vitet në vijim, sipas deklaratave periodike vjetore të subjektit e bashkëshortit, janë përfshirë: në vitin 2011 shuma prej 10.000 euro, në vitin 2012, shuma prej 7.575 euro, dhe në vitin 2013, shuma prej 35.759 euro, që përbën diferencën e mbetur nga çmimi i blerjes.

**15.12.** Me rezultatet e hetimit, subjektit i kaloi barra e provës për: (a) mospërputhjet në lidhje me çmimin e paguar për blerjen e këtij apartamenti dhe kohën e kryerjes së pagesës, sipas kontratës së shitblerjes dhe deklarimeve të subjektit; (b) mosdeklarimin e kontratës për furnizim me energji elektrike në datën 14.11.2007 dhe mosdeklarimin e marrëdhënies me këtë pasuri dhe/ose pagesave të kryera në deklaratat periodike vjetore të viteve 2007, 2008 dhe 2009; (c) rezultatin financiar paraprak që evidenton mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen e kësaj pasurie [në datën 10.05.2010 me balancë negative 1.003.580 lekë; në vitin 2012 me balancë negative në vlerën 1.357.110 lekë dhe në vitin 2013 me balancë negative në vlerën 2.898.089 lekë] si dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këto periudha.

**15.13.** Në prapësime, subjekti ka pretenduar sikurse në ankim dhe ka kërkuar që të mbahet në konsideratë shkresa që mban datën 12.04.2022, lëshuar nga shitësi/shoqëria e ndërtimit, sipas së cilës ai/shitësi shprehet se ka kryer gabime në kontratën e shitblerjes. Subjekti po ashtu ka pretenduar se çmimi është likuiduar me 48 mandatpagesa gjatë viteve 2010 – 2015. Po ashtu, ajo ka kontestuar edhe analizën financiare të vitit 2010, duke pretenduar edhe që shuma 8.000 euro, që referohet e paguar më datë 10.05.2010 në kontratën e porosisë, nuk është paguar në atë datë por me këste. Sipas këtij kalendarit pagesash, shuma prej 8.000 eurosh është shlyer *përgjatë* vitit 2010, sipas katër (4) mandatarkëtimeve me numrat përkatës dhe duhet të fragmentarizohet për të gjithë vitin 2010. Po ashtu, subjekti ka kërkuar që në analizën e vitit 2013, të përfshihet si shpenzim për këtë pasuri vetëm shuma 5.000 euro, ndërsa pjesa tjetër të shtrihet në vitet 2014 dhe 2015, përkatësisht në shumat 11.997 dhe 10.000 euro.

<sup>39</sup> Akt jo noterial, i mbajtur në ambientet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>40</sup> Sipas akt-rakordimit, referohen pagesat si vijon: 8.000 euro në vitin 2010; 10.000 euro në vitin 2011; 7.575 euro në vitin 2012 dhe 5.000 euro në vitin 2013.

**15.14.** Subjekti ka prapësuar se kontrata për furnizim me energji elektrike që daton në nëntor 2007, në emër të bashkëshortit, është hapur thujse 5 (pesë) vite më pas, në datën 12.07.2012, në bazë të kërkesës së bashkëshortit për ndryshimin e emrit të abonentit nga shoqëria {\*\*\*} ShPK, tek pronari (bashkëshorti i subjektit).

**15.15.** Trupi gjykues i Kolegjit, e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit e po ashtu edhe mënyrën e arsyetimit për këtë aspekt. Së pari, në përgjigje të pretendimeve mbi fuqinë provuese të akteve, trupi gjykues çmon të theksojë se analiza në vijim, në kuadër të procesit të rivlerësimit, nuk ka për qëllim të krijojë një analizë teorike të ligjit material civil. Nën këtë qasje, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se mes akteve, përparësi për shkak të ligjit merr kontrata e shitblerjes. Ky akt është formalizuar me kontratë noteriale në përputhje me kërkesat e Kodit Civil<sup>41</sup> për vlefshmërinë e veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to kundrejt asaj të porosisë. Përkundër kësaj kontrate, ajo e porosisë është formalizuar në një akt të thjeshtë *jo noterial* të lidhur ndërmjet palëve. Kjo premisë ka rëndësi nisur nga mospërputhjet ndërmjet dy kontratave të mësipërme lidhur me çmimin e pasurisë, i cili në kontratën e porosisë është dukshëm më i ulët se ai i përcaktuar në kontratën e shitjes. Për shkak të formës, kontrata e porosisë që përbën një shkresë të thjeshtë [private], krahasuar me aktin noterial që merr datë të saktë, që regjistrohet në regjistrat publikë dhe kopjet e të cilit arkivohen e administrohen nga noteri publik, ka vlerë provuese të kufizuar përsa i përket më së paku, datës që është shënuar në të.

**15.16.** Kontrata e shitblerjes dhe kartela e pasurisë së paluajtshme, të përpiluara respektivisht nga noteri publik apo nëpunësi i shtetit, konsiderohen në kuptim të Kodit Civil si *akte zyrtare*<sup>42</sup> që kanë forcën e ligjit për palët<sup>43</sup>. Ky akt përbën *provë të plotë* të deklarimeve të tyre para noterit, për faktet që kanë ngjarë në prani të tij. Për këto fakte lejohet të provohet e kundërta, vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar. Kontrata e sipërcituar e shitblerjes po ashtu i ka sjellë efektet e saj. Kontrata e porosisë, duke qenë *shkresë e thjeshtë*, në kuptim të nenit 258 të Kodit të Procedurës Civile, në bazë të nenit 259 të këtij kodi, përbën provë të plotë se deklaratimet që përmban janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi kundër të cilit paraqitet shkresa pranon këtë fakt. Në rastin konkret, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me shkresën nr. {\*\*} prot., datë 12.04.2022, drejtuar bashkëshortit të subjektit pranon se ka nënshkruar kontratën e porosisë e si rrjedhojë, përbën provë të plotë *për palët nënshkruese*. Në linjë me arsyetimin më sipër, mes dy akteve, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson së çmimi i pasurisë objekt analize është ai i përcaktuar nga palët në aktin zyrtar, kontratën e shitblerjes, që është depozituar në AShK.

**15.17.** Së dyti, shkresa që mban datën 03.02.2014, titulluar “akt-rakordimi”, sipas të cilës palët kanë korrigjuar kontratën e shitblerjes, paraqet probleme të spikatura të besueshmërisë. Së pari, kjo shkresë është paraqitur për herë të parë nga subjekti në shkurt 2015 në ILDKPKI,<sup>44</sup> gjatë

<sup>41</sup> Referuar neneve 79, 80, 81, 83, 659, 663 dhe 913 - 934 të Kodit Civil.

<sup>42</sup> Neni 253 i Kodit Civil parashikon: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

<sup>43</sup> Neni 690 i Kodit Civil parashikon: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

<sup>44</sup> Referuar procesverbalit datë 16.02.2015.

kontrollit të ushtruar nga ai institucion. Nëpërmjet kësaj shkrese të thjeshtë, subjekti ka synuar të kontestojë një shkresë zyrtare si kontrata e shitjes përse i përket çmimit, dhe detyrimit të mbetur të pashlyer, duke pretenduar që në fund të vitit 2013, ajo dhe bashkëshorti kishin pa shlyer shumën 21.997 euro, të cilën e shlyen gjatë viteve 2014 dhe 2015. *Së fundmi*, subjekti është shprehur se për të regjistruar pasurinë, “u shënua” se vlera e shitjes është likuiduar tërësisht, ndonëse ishte paguar vetëm pjesërisht.

**15.18.** Nën dritën e përcaktimeve të nenit 50 të ligjit të kohës “Për noterin” (nr. 7829/1994), rezulton që palët në këtë kontratë, në momentin e konstatimit të vendosjes në kontratën e shitblerjes të çmimit të gabuar prej 61.334 eurosh, duhej t’i drejtoheshin noterit për korrigjimin e gabimit, sipas procedurës së përcaktuar nga dispozita e sipërcituar<sup>45</sup>. Korrigjimi i këtij gabimi material *thelbësor* në kontratën e shitblerjes, duhej të bëhej nga noteri në prezencë të palëve dhe jo nga këto të fundit nëpërmjet një akti të thjeshtë si ai i paraqitur nga subjekti, pavarësisht nga titullimi. Në këtë kontekst, është e pakuptimtë, e për rrjedhojë e pabesueshme edhe qasja e palëve [subjekti dhe bashkëshorti, me njohuri të posaçme ligjore], për të mos iu drejtuar noterit për korrigjimin e një elementi kontraktual esencial, sikurse çmimi i pasurisë.

**15.19.** Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, edhe pretendimet e subjektit për kalendarin e pagesave, të ndryshëm nga ai i përcaktuar në kontratën e porosisë dhe në deklaratat periodike vjetore të subjektit dhe bashkëshortit, të dy subjekte deklarues, janë të pabesueshme. Për rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegji, shlyerja e pasurisë u përlllogarit sipas aktit të vetëm të kohës – deklaratat periodike vjetore të viteve përkatëse. Konkretisht, duke nisur nga kontrata e porosisë, në kushtet që palët janë shprehur në maj 2010 *se “porositësi ka për të likuiduar vetëm 8.000 euro, ndërsa diferencën do ta likuidojë me këste”*, përjashton mundësinë e likuidimit të shumës 8.000 euro me këste. Nga ky parashikim rezulton se shuma 8.000 euro është paguar njëherësh në momentin e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca do të likuidohej me këste, në vijim. E njëjta situatë deduktohet edhe nga deklarata periodike vjetore e vitit, në të cilën subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, kanë deklaruar shumën 8.000 euro *si të vetme*, pa specifikuar mandatpagesa apo këste.

**15.20.** Së dyti, vërehen mospërputhje mes vlerave të referuara tek mandatarkëtimet e depozituara me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, me ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit. Ndër to, mandatarkëtimi i numërtuar me nr. {\*\*\*}, datë 30.04.2010 [para datës 10.05.2010 të kontratës së porosisë], i vulosur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, referon për pagesë vlerën 11.810 euro me përshkrimin “*kësti i parë, blerje lokali me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 43.81 m<sup>2</sup>, tek pallati “{\*\*\*}”*. Për të njëjtin vit, 2010, evidentohet edhe një tjetër mandatarkëtimi me nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2010, që referon për pagesë shumën 7.185 euro, me përshkrimin “*kësti i dytë, blerje dyqani nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}*”. Në vijim, në mandatin nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2011, përshkruhet për arkëtim kësti i tretë me vlerë 5.000 euro dhe krahas tij, përshkruhen dy këstet e para 11.810 euro dhe 7.185 euro dhe vlera e mbetur e detyrimit.

---

<sup>45</sup> Neni 50 i ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, parashikonte: “Në aktin noterial nuk lejohet të bëhen prishje fjalësh e fjalish dhe as shkarravitje. Nëse lind nevoja për të hequr fjalë a fjali, ato vihen në kllapa, nënvizohen dhe në vijim përmendet sa fjalë a fjali janë hequr. Përbri tyre nënshkruajnë palët dhe noteri; ato nuk kanë vlefë dhe nuk merren parasysh në tërësinë e aktit. Kur akti përbëhet nga disa faqe, ato duhen numëruar e lidhur”.

**15.21.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit se Komisioni ka mbajtur qëndrim kontradiktor lidhur me mandatpagesat, duke diferencuar mes atyre që datojnë në vitet 2014 – 2015 kundrejt atyre të viteve 2010 – 2013 të cilave u ka dhënë fuqi të plotë provuese. Komisioni ka specifikuar se përlllogaritjen e çmimit të njësisë [61.334 euro] dhe kalendarin e likuidimit të tij e ka bazuar në: (i) kontratën e porosisë dhe deklaratën periodike për vitin 2010, për shumën 8.000 euro të paguar në vitin 2010; (ii) në deklaratat periodike për vitet 2011 dhe 2012 [përkatësisht për shumat 10.000 euro dhe 7.575 euro] dhe për diferencën prej 35.759 eurosh, e mbetur nga vlera totale e çmimit të blerjes, është referuar (iii) në kontratën e shitblerjes, sipas të cilës çmimi prej 61.334 eurosh është likuiduar *totalisht* nga blerësi. Pra, në përlllogaritjen e çmimit dhe kalendarit të pagesave, Komisioni nuk rezulton të jetë bazuar në mandatpagesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit. Përkundrazi, referuar pikave 11.18 - 11.21 të vendimit, Komisioni *nuk* ka pranuar mandatpagesat *e asnjë viti*.

**15.22.** Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, qëndrimi i Komisionit është i bazuar. Në linjë me arsyetimin më sipër për dallimin mes akteve për nga natyra e tyre, edhe mandatarkëtimet janë shkresa private me fuqi provuese vetëm për palët. Për efekt të procesit të rivlerësimit, besueshmëria e këtyre provave dhe pajtueshmëria e dukshme me provat e tjera, duhet vlerësuar në kuptim të nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 84/2016. Duke rikonfirmuar jurisprudencën e Kolegjit<sup>46</sup>, për rastet në të cilat është arsyetuar gjerësisht mbi rregullsinë e dokumenteve justifikuese/mandateve në raport me kuadrin ligjor të kontabilitetit, mandatarkëtimet e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, nuk janë hartuar sipas kërkesave të nenit 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”, dhe “Sistemit kontabël të përgjithshëm”, pika 2.2, “Rregullat e përgatitjes së dokumenteve justifikuese”. Përveçse të pavulosura nga shoqëria, atyre u mungon adresa e saj (selia), numri i llogarisë në të cilën janë arkëtuar shumat përkatëse, personi që urdhëron kryerjen e veprimit dhe as personi që ekzekuton veprimin.

**15.23.** Edhe duke abstraguar nga problematika e formës së plotësimit, mandatarkëtimet e viteve 2014 dhe 2015, të cilat duken të plotësuara në përputhje me kërkesat ligjore të mësipërme, nuk janë të besueshme për shkak se ato vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes sipas të cilës, në datën e lidhjes së asaj kontrate, në 18.02.2013, çmimi prej 61.334 euro, është likuiduar *totalisht* nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Për rrjedhojë, nën dritën e pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për këto aspekte me rëndësi përcaktuese për këtë pasuri, sikurse çmimi i pasurisë dhe kalendari i pagesave, këto mandatpagesa nuk mund të argumentohen se janë provë mbi të cilën duhet kryer vlerësimi. Për më tepër, pretendimi i subjektit se likuidimi i pagesave nuk ka përfunduar në vitin 2013 sipas kontratës, por ka vijuar të kryhet në vitet 2014, e 2015 sipas mandatarkëtimeve, apo potencimi i “akt-rakordimit” si provë, mbetet i pambështetur në akte dhe ligj, në kushtet që në vijim të analizës ligjore të referuar më sipër, korrigjimi i kontratës së shitjes për aspekte kyçe të saj – çmimi dhe mënyra e kalendari i pagesave – për ta bërë këtë akt zyrtar, duhet të bëhej nga noteri në prezencë të palëve dhe jo nga këto të fundit nëpërmjet një akti të thjeshtë. Edhe specifikimi në akt rakordim se *gjatë viteve 2014 dhe 2015* është likuiduar shuma e mbetur prej 21.997 eurosh, është në kontradiktë me disa mandate në të cilat përshkruhet vlera e mbetur e detyrimit. Konkretisht, në

---

<sup>46</sup> Vendimet: nr. 8, datë 16.04.2019, pika 39, për subjektin e rivlerësimit A. N.; nr. 16, datë 26.05.2022, pika 28, për subjektin e rivlerësimit M. V..

mandatin nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2011, përshkruhet për arkëtim kësti i tretë me vlerë 5.000 euro dhe krahas tij, përshkruhen dy këstet e para 11.810 euro e 7.185 euro dhe vlera e mbetur 28.577 euro. Më tej, në mandatin nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2012, përshkruhet detyrimi i mbetur prej 11.002 eurosh. Ky detyrim i mbetur deri në maj 2012, është më i vogël se shumta prej 21.997 eurosh e cila në akt rakordim referohet si detyrim i mbetur pa paguar deri në vitin 2013 e që është likuiduar në vitet 2014 e 2015.

**15.24.** Bindjen se mandatarkëtimet janë të pabesueshme, e përforcojnë edhe disa mospërputhje të konstatuara në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ. Konkretisht, përpos sa referuar më sipër për faktin që palët janë shprehur për pagesën prej 8.000 eurosh si një e vetme në kontratën e porosisë, dhe si në katër pjesë – sikurse pretendon subjekti gjatë kontrollit nga ILDKPKI e në hetimin administrativ – nga krahasimi i vlerave të deklaruara të shlyera në aktet e kohës me mandatpagesat e sjella, mospërputhje evidentohen edhe ndërmjet shumave të urdhëruara për arkëtim me shumat e arkëtuara. Konkretisht:

- i. Në mandatin nr. {\*\*\*}, që daton përpara kontratës së porosisë, në 30.04.2010, dhe në mandatin nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2010, shoqëria {\*\*\*} ka urdhëruar arkëtimin respektivisht të këstit të parë me vlerë 11.810 euro dhe këstit të dytë prej 7.185 eurosh, ose një total prej thujse 19.000 euro. Subjekti jo vetëm që nuk ka dhënë asnjë shpjegim për këto mandate, por pretendon se gjatë vitit 2010 është paguar vetëm shumta 8.000 euro, në katër pjesë “gjatë vitit” ndryshe nga sa parashikohet në kontratën e porosisë, në deklaratën periodike dhe në këto dy mandatpagesa.
- ii. E njëjta situatë konstatohet edhe për vitin 2011. Në vijim të këstit të parë, prej 11.810 eurosh, është urdhëruar me mandatet nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2011, nr. {\*\*\*}, datë 30.04.2011 dhe nr. {\*\*\*}, datë 25.07.2011, arkëtimi i tre kësteve vijues në vlerat respektive 5.000 euro secili. Vlera totale prej 15.000 eurosh e urdhëruar përmes këtyre mandateve nuk përputhet me vlerën totale prej 10.000 eurosh të pretenduar nga subjekti se është paguar gjatë vitit 2011 [me mandatet nr. {\*\*\*} datë 25.01.2011, nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2011, nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2011, nr. {\*\*\*}, datë 12.07.2011 dhe nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2011].
- iii. E njëjta tipologji vërehet edhe për vitin 2012, ku përmes mandatit nr. {\*\*\*} datë 04.05.2012 është urdhëruar arkëtimi i këstit prej 7.575 eurosh dhe përshkruar njëkohësisht edhe detyrimin e mbetur për likuidim në vlerën 11.002 euro. Kjo vlerë e mbetur është më e vogël se detyrimi i papaguar prej 28.577 eurosh i cili sipas akt rakordimit u pagua gjatë viteve 2014 dhe 2015. Është pikërisht ky mandat me nr. {\*\*\*}, që është deklaruar nga vetë subjekti dhe bashkëshorti i saj në DIPP 2012. Pa dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë mandat, subjekti riciton në ankim se shumta 7.575 euro u likuidua nëpërmjet mandateve nr. {\*\*\*} datë 11.04.2012 në shumën 2.050 euro, nr. {\*\*\*} datë 17.07.2012 në shumën 2.000 euro, nr. {\*\*\*} datë 18.09.2012 në shumën 1.900 euro dhe nr. {\*\*\*} datë 11.12.2012 në shumën 1.625 euro. Edhe duke abstraguar nga fakti që shumta 7.575 euro është urdhëruar të paguhet njëherësh dhe jo me këste, sërish mandatet e cituara prej subjektit nuk mund të pretendohet se janë paguar në bazë të mandatit urdhërues, pasi njëri prej tyre mban datën 11.04.2012, pra, një muaj përpara urdhërimit.

- iv. Për vitin 2013 subjekti pretendon se ka arkëtuar shumën 5.000 euro nëpërmjet tre mandatarkëtimeve nr. {\*\*\*} datë 21.01.2013 me vlerë 1.800 euro, nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2013, me vlerë 1.100 euro dhe nr. {\*\*\*} datë 07.04.2013 me vlerë 2.100 euro. Subjekti nuk jep asnjë shpjegim në lidhje me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 08.02.2013, i cili referon për pagesë këstin prej 5.000 eurosh. Është pikërisht ky mandat që është cituar në deklaratën periodike për vitin 2012 të subjektit dhe të bashkëshortit. Njëjtë si më lart, dy prej mandateve të cituara nga subjekti datojnë para këtij mandati urdhërues e për rrjedhojë nuk mund të pretendohet se janë likuiduar në zbatim të tij. Pra nëse do të konsideroheshin të gjithë këto mandate, vlera e paguar në vitin 2012 do të ishte 10.000 euro dhe jo 5.000 euro sipas pretendimit.
- v. *Së fundmi*, subjekti ka depozituar në Komision vetëm mandatarkëtimet, por jo akte të tjera të shoqërisë që konfirmonin të dhënat me akte të kohës. Madje në kthimin e përgjigjes datë 12.04.2022 drejtuar bashkëshortit të subjektit, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka konfirmuar versionin e subjektit mbi vlerat e paguara për vitet 2010-2014, pa specifikuar në shkresë numrat dhe datat e mandateve respektive dhe mbi të gjitha pa ia bashkëlidhur ato shkresës, duke u shprehur vetëm që ato janë voluminoze dhe se një kopje të tyre duhet ta ketë edhe vetë subjekti.

15.25. Vetëm këto mospërputhje, pa qenë nevoja për të kryer verifikime të mëtejshme, mjaftojnë për të krijuar bindjen se mandatarkëtimet e sjella nga subjekti kanë probleme në vetvete dhe nuk janë të besueshme, dhe si rrjedhojë pa vlerë provuese për pretendimet e subjektit. Në analizën e kryer në Kolegj u përlllogaritën vlerat financiare dhe koha e pagesës sikurse në Komision, pavarësisht prej mospërputhjeve, duke mbajtur në konsideratë garancitë procedurale me ankimin. të vlerave arsyetuar më sipër.

15.26. Në përmbyllje të pretendimeve mbi çmimin e njësisë dhe modalitetet e likuidimit të tij, duke u bazuar në qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit për vlerën provuese të aktet zyrtare përfshirë kontratat e shitblerjes, që kanë forcën e ligjit për palët dhe mund të goditen vetëm për falsitet, ashtu edhe në sa më sipër konstatuar lidhur me besueshmërinë e mandatpagesave, trupi gjykues i Kolegjit thekson se kontrata e shitblerjes datë 08.02.2013 dhe kartela e pasurisë së paluajtshme, në të cilat është shprehur qartë vullneti final i palëve për çmimin e pasurisë në vlerën 61.334 euro, përbën provë të besueshme dhe me vlerë provuese të pakontestueshme. Aktet e tjera të depozituara nga subjekti e konkretisht, kontrata e porosisë datë 10.05.2010, “akt-rakordimi”, mandatarkëtimet dhe shkresa datë 12.04.2022 e shoqërisë ndërtuese drejtuar bashkëshortit të subjektit, janë shkresa private të thjeshta, të cilat në procesin e rivlerësimit nuk rezultuan të besueshme pasi nuk pajtohen me provat e tjera, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

b. *Analiza financiare e burimeve të ligjshme të disponuara për investimin në njësinë e shërbimit*

15.27. Për analizën financiare ndër vite, subjekti parashtron dhe kërkon konkretisht sa vijon:

(i) për vitin 2010, pagesa 8.000 euro të shtrihet gjatë gjithë vitit, sipas katër mandatarkëtimeve të depozituara në Komision, referuar në paragrafin 15.13 më sipër, nga maji deri në tetor. Po ashtu, subjekti kërkon që nga analiza financiare e vitit 2010, duhet të

përfshihet një zë që përfaqëson një tërheqje nga bashkëshorti në Raiffeisen Bank në datë 28.06.2010, e një shume prej 1.950.000 lekësh. Subjekti konteston autenticitetin e këtij transaksioni duke pretenduar se nuk është kryer nga bashkëshorti i saj e duhet të jetë gabim i personelit bankar, i cili njihet rëndom nën termin “stornim”. Sipas saj, banka e ka bërë me dije se kjo shumë është derdhur në formën e një garancie bankare, por në emër të bashkëshortit të saj nuk ka rezultuar ndonjë garanci bankare. Subjekti pretendon se ajo dhe personi i lidhur nuk mund të kenë paguar garanci bankare pasi nuk ndodhen në asnjë nga situatat për të cilat ajo paguhet zakonisht, sikurse mund të jetë një konflikt gjyqësor apo një marrëdhënie importi nga shoqëri tregtare. Në kushtet që nuk ka dokumentacion që të vërtetojë nënshkrimin nga bashkëshorti, kjo transfertë bankare nuk mund të konsiderohet si veprim i kryer prej tij.

(ii) Në analizën financiare *të vitit 2012*, vlera prej 17.000 eurosh nuk duhet të përfshihet si pagesë e kryer nga bashkëshorti për pasurinë në Qerret të qytetit të Kavajës [sikurse referuar më sipër, përfshirë në analizën e vitit si zë nga Komisioni ndonëse nuk është konsideruar si pasuri e fshehur e subjektit].

(iii) Në analizën financiare *të vitit 2013*, duhet të konsiderohet si pagesë për njësinë e shërbimit vetëm vlera prej 5.000 eurosh e paguar sipas mandateve respektive<sup>47</sup> sikurse deklaruar në DIPP-në e këtij viti. Vendosija e një çmimi më të lartë në kontratën e shitjes së vitit 2013 ishte një gabim i shoqërisë ndërtuese, i cili u saktësua me anë të akt-rakordimit të datës 03.02.2014, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Në këtë analizë nuk duhet të përfshihet si shpenzim, shuma 8.102 euro [diferenca mes çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes e atij të përcaktuar në kontratën e porosisë] dhe as shumat 11.997 euro dhe 10.000 euro [paguar respektivisht në vitet 2014 dhe 2015]. Nga mospërfshirja e këtyre shumave, analiza financiare për këtë vit, do të rezultonte në një bilanc pozitiv.

(iv) Në analizën financiare *të vitit 2014*, duhet të përfshihet si shpenzim për pasurinë në fjalë, shuma 11.997 euro e cila provohet me mandatpagesat<sup>48</sup> përkatëse të dorëzuara si provë në Komision. Në këtë rast, do të rezultonte një balancë e vogël negative prej (-) 110.308 lekësh edhe kjo, si rrjedhojë e kursit të këmbimit të euros. Nëse në analizën financiare të këtij viti do të korrigjohej edhe zëri i shpenzimeve të kryera me kartë krediti të cilat në një pjesë të konsiderueshme janë përfshirë në shpenzimet jetike, atëherë rezultati negativ nuk do të konsiderohej si pamjaftueshmëri financiare.

(v) Në analizën financiare *të vitit 2015*, duhet të përfshihet si shpenzim për pasurinë në fjalë shuma e deklaruar prej 10.000 eurosh/1.540.090 lekë, e provuar me mandatpagesat<sup>49</sup> e depozituara si prova në Komision. Në këtë rast, rezultati financiar i vitit 2015 do të rezultonte pozitiv.

---

<sup>47</sup> Subjekti citon në ankim tre mandatarkëtime e konkretisht: (i) nr. {\*\*\*} datë 21.01.2013 për shumën 1800 euro/251.172 lekë; (ii) nr. {\*\*\*} datë 07.02.2013 për shumën 1100 euro/153.670 lekë; (iii) nr. {\*\*\*} datë 07.04.2013 për shumën 2100 euro/293.055 lekë.

<sup>48</sup> Subjekti citon mandatet: nr. {\*\*\*}. datë 13.01.2014; nr. {\*\*\*}. datë 10.02.2014; nr. 214. datë 15.03.2014; nr. {\*\*\*}. datë 21.04.2014; nr. {\*\*\*}. datë 08.05.2014; nr. {\*\*\*}. datë 11.06.2014; nr. {\*\*\*}. datë 17.07.2014; nr. {\*\*\*}. datë 15.08.2014; nr. {\*\*\*}. datë 10.09.2014; nr. {\*\*\*}. datë 21.10.2014; nr. {\*\*\*}. datë 25.11.2014 dhe nr. {\*\*\*}. datë 10.12.2014.

<sup>49</sup> Subjekti citon mandatet: nr. {\*\*\*}. datë 05.01.2015; nr. {\*\*\*}. datë 07.02.2015; nr. {\*\*\*}. datë 22.04.2015; nr. {\*\*\*}. datë 17.05.2015; nr. {\*\*\*}. datë 15.06.2015; nr. {\*\*\*}. datë 10.07.2015; nr. {\*\*\*}. datë 11.08.2015. në shumën 800 euro; nr. {\*\*\*} datë 10.09.2015, nr. {\*\*\*}. datë 17.10.2015; nr. {\*\*\*}. datë 08.11.2015 dhe nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2015.

**15.28.** Në përfundim të kontrollit të ushtruar në lidhje me pasurinë njësi shërbimi (objekt vlerësimi), pavarësisht korigjimeve në analizën financiare si rrjedhojë e pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit, edhe në Kolegj rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur, *nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme* pagesën e kështit të parë në vitin 2010 dhe pagesën e kësteve në vitin 2013. Po ashtu, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti *ka kryer deklarim të pasaktë* të çmimit të kësaj pasurie. Për vlerësimin e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit u bazua në situatën faktike e ligjore që rezultoi nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi dhe i akteve që administrohen në dosjen e Komisionit. Arsyetimi i Kolegjit fillimisht bëhet në lidhje me grupin e parë të pretendimeve me fokus çmimin e pasurisë dhe mënyrën e likuidimit si më lart analizuar, dhe në vijim të tij, shtjellohen pretendimet me fokus analizën financiare të kryer për këtë pasuri.

**15.29.** Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se në funksion të analizës financiare të vitit 2010, pretendimet e subjektit për veprimet bankare të depozitës në qershor 2010 të një shume nga bashkëshorti u gjetën me mungesë besueshmërie. Duke mbajtur në konsideratë që gjeneralitetet identifikuese të veprimeve bankare pasqyrojnë saktësisht të dhënat e identitetit të bashkëshortit, e konkretisht numrin e kartës së identitetit të tij, ndonëse gabimisht referuar si numër pasaporte, si dhe faktin që pretendimi për gabim mbeti deklarativ, ky depozitim *u përfshi* në analizën financiare për vitin përkatës. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit, rezultoi edhe në Kolegj se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë patur mundësi të depozitojnë vlerën 1.950.000 lekë në datën 28.06.2010. Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të padrejtë vlerësimin e Komisionit për të pasqyruar këtë vlerë si shpenzim në analizën financiare, pasi nuk pasqyrojnë situatën faktike të shpenzimeve të kryera.

**15.29.a.** DPPPP-ja ka informuar Komisionin në lidhje me raportime nga noterët dhe nga bankat. Nga ky informacion rezultoi se në të njëjtën datë 28.06.2010, pranë Raiffeisen Bank janë kryer *dy transaksione* nga bashkëshorti i subjektit [K. M. O.] *në shumën 1.950.000 lekë*, njëri me shënimin “Tërheqje nga llogaria”, debitim, dhe tjetri me shënimin “Derdhje cash për garanci bankare”, kreditim. Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar transaksionin e sipërpërmendur, burimin apo destinacionin e shumës cash pas tërheqjes në deklaratën periodike për vitin 2010, sikurse as shtesë e kursimeve cash në banesë, në datën 31.12.2010. Komisioni konstatoi se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar depozitimin e kësaj shume në datën 28.06.2010.

**15.29.b.** Shkresa nga Raiffeisen Bank bën me dije<sup>50</sup> se *nuk ka të dhëna që të vërtetojnë kryerjen e një transaksioni të gabuar*. Referuar ekstraktit të llogarisë bankare të përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, tërheqja e shumës 1.950.000 lekë më datë 28.06.2010, është kryer nga klienti K. O. [mungon atësia] me *numër pas. {\*\*\*}*. Ky numër rezultoi të jetë numri i

---

<sup>50</sup> Me shkresën e datës 15.04.2022 drejtuar bashkëshortit të subjektit, Raiffeisen Bank bën me dije se: “[...] nuk disponojmë kopje të dokumentave bankare të këtyre veprimeve, pasi afati i ruajtjes [...] është 10 vjet. [...] Mbas verifikimeve të kryera në sistemet e bankës, nuk kemi gjetur të dhëna që të vërtetojnë se jemi në kushtet e kryerjes së një transaksioni të gabuar. Mund të konfirmojmë se nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar ndonjë garanci bankare në emër të K. O.. Gjithashtu nuk rezultoi të jetë paguar ndonjë komision, që aplikohet në rastet kur kërkohet vërtetim për gjendjen e llogarisë në një datë të caktuar [...] sipas sistemit rezultoi se fillimisht është kryer veprimi i derdhjes së shumës prej 1.950.000 lekë në degën “{\*\*\*}”, Tiranë dhe më pas është kryer veprimi i tërheqjes në degën e Raiffeisen Bank rr. “{\*\*\*}”. Nga sistemi nuk mund të nxjerrim të dhëna lidhur me orën e kryerjes së veprimit të depozitimit të shumës, ndërsa veprimi i tërheqjes së shumës në degën e Raiffeisen Bank, rr. “{\*\*\*} është kryer në orën 10:30”.

letërnjoftimit të bashkëshortit të subjektit, i pasqyruar në kontratën e porosisë për pasurinë objekt analize dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

**15.30.** Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se përjashtohet mundësia që këto veprime të jenë kryer nga një person tjetër, me gjeneralitete identike me ato të bashkëshortit të subjektit. Pas verifikimit të dokumentacionit bankar dhe dy printimeve të llogarive të bashkëshortit, u vlerësua i pabazuar edhe pretendimi i subjektit për *stornim*<sup>51</sup> nga punonjësit e bankës. Trupi gjykues e gjen të pasinqertë subjektin, teksa nga shkresa e bankës, në pretendimet e saj, *ometon* pikërisht fragmentin që konfirmon se nuk ka transaksion të gabuar. Duke mbajtur në konsideratë që gjeneralitetet identifikuese të veprimeve bankare pasqyrojnë saktësisht të dhënat e identitetit të bashkëshortit, e konkretisht numrin e kartës së identitetit të tij, ndonëse gabimisht referuar si numër pasaporte, si dhe faktin që pretendimi për gabim të punonjësve të bankës mbeti deklarativ, ky depozitim *u përfshi* në analizën financiare për vitin përkatës.

**15.31.** Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të padrejtë vlerësimin e Komisionit për të pasqyruar këtë vlerë si shpenzim në analizën financiare, pasi nuk pasqyron situatën faktike të shpenzimeve të kryera. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2010 - 28.06.2010, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për depozitimin e vlerës prej 1.950.000 lekë në datën 28.06.2010, pagesën e kështit për pasurinë zyrë në datën 10.05.2010 dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera gjatë kësaj periudhe. Kjo analizë rezultoi me një balancë negative prej (-) 2.773.051 lekësh.

**15.32.** Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit për të mos përfshirë në analizën financiare të vitit 2012 shumën prej 17.000 eurosh, e depozituar në bankë më datë 01.10.2012, pranë Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim BKT) për blerjen e një pasurie të ndodhur në Malin e Robit, fshatin Qerret të Kavajës. Në kushtet që Komisioni ka konkluduar se indiciet e rezultuara nga informacioni ishin të pamjaftueshme për të mbështetur dyshimin se kjo pagesë ishte kryer nga bashkëshorti i subjektit, përfshirja e kësaj vlere në analizën e vitit 2012 në vendim, është e pakuptimtë. Për rrjedhojë, në analizën e kryer në Kolegj kjo vlerë financiare *nuk* u konsiderua si shpenzim në analizën e vitit 2012. Pas këtij korrigjimi, në Kolegj u përmbys balanca negative e Komisionit dhe viti 2012 rezultoi me mundësi për përballimin e shpenzimeve dhe investimeve.

**15.33.** Komisioni ka analizuar në vendim vetëm qëndrimin e subjektit lidhur me çmimin e njësisë së shërbimit në Tiranë dhe mënyrën e likuidimit të tij. Ndërsa në pikën 11.24 të vendimit, Komisioni nuk ka bërë arsyetim ligjor dhe analizë të provave të depozituara nga subjekti lidhur me transaksionin prej 17.000 eurosh, por vetëm ka vlerësuar se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe pretendimi se derdhja e shumës 17.000 euro në llogari të shoqërisë ndërtimore, nuk ishin transaksione të kryera nga bashkëshorti, ngeli vetëm në nivel deklarativ. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se kjo mungesë analize nuk e bën vendimin të cenueshëm në tërësinë e tij.

**15.34.** Për të shëruar mungesën e arsytimit si edhe për vlerësimin e themelit të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet në fashikull, vëren se ato referojnë një tjetër individ me gjeneralitete të ngjashme me bashkëshortin e subjektit, por me atësi të

---

<sup>51</sup> Veprim i kryer gabimisht dhe i anuluar më pas brenda ditës.

ndryshme. Po ashtu, konkluzioni i paraqitur nga eksperti kriminalist H. K., në akt ekspertimin datë 20.04.2022, duket se e *konfirmon pretendimin e subjektit* se shuma 17.000 euro e derdhur në arkë, për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nuk është kryer prej bashkëshortit të saj z. K. M. O.. Rrjedha e mësipërme e arsyetimit të fakteve, gjeti pasqyrim edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2012. Në këtë analizë, vlera prej 17.000 eurosh e derdhur për llogari të shoqërisë {\*\*\*} ShPK, u përjashtua nga analiza financiare e vitit 2012. Pas këtij korrigjimi në Kolegj, bilanci financiar i vitit 2012, rezulton pozitiv.

**15.35.** Në Kolegj u krye analiza financiare për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e mbetur prej 35.759 eurosh në vitin 2013, si këst i fundit i pagesës për pasurinë zyrë, sikurse u arsyetua më lart. Kërkimi i subjektit për të përjashtuar nga analiza e këtij viti shumat 11.997 euro dhe 10.000 euro dhe për t'i përfshirë ato në analizën financiare të viteve respektive 2014 dhe 2015, u vlerësua i pabazuar sipas arsyetimit të bërë në paragrafët më lart. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e kësteve në vitin 2013, njësoj si në analizën e Komisionit.

**15.36.** Në përfundim, nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit për këtë pasuri, pavarësisht korrigjimeve në analizën financiare si rrjedhojë e pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit, rezulton edhe në Kolegj subjekti dhe personat e lidhur, *nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme*, pagesën e këstit të parë në vitin 2010 dhe pagesën e kësteve në vitin 2013. Konkretisht: (i) subjekti dhe personat e lidhur nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme, pagesën e këstit të parë të njësisë, në vitin 2010, duke rezultuar me një diferencë negative prej (-) 1.003.580 lekësh në datën 10.05.2010; (ii) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi të depozitojnë vlerën prej 1.950.000 lekësh në datën 28.06.2010; (iii) subjekti dhe bashkëshorti nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e kësteve në vitin 2013, duke rezultuar me një diferencë negative për vitin 2013 prej minimalisht (-) 2.898.089 lekësh. Po ashtu, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të çmimit të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, gjenden në kushtet e pikave 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutë pasi kanë kryer deklaram të pasaktë dhe kanë mungesë burimesh të ligjshme për krjimin e kësaj pasurie, parashikuar nga neni 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV.** *Automjeti i blerë në datën 25.03.2008*<sup>52</sup>

- 16.** Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur/djali i subjektit, ka deklaruar pronësinë individuale mbi automjetin objekt shqyrtimi, të blerë në datën 25.03.2008, vlerën 10.200 euro si edhe burimet për blerjen e kësaj autoveture: të ardhurat nga *shitja* e një automjeti tjetër, në shumën 1.173.333 lekë dhe *kursimet* e familjes. Subjekti dhe bashkëshorti veçmas, në deklaramet përkatëse periodike për vitin 2008 kanë deklaruar blerjen, me dallimin që bashkëshorti ka referuar si burime të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm në vitin 2007.

<sup>52</sup> I llojit “Mercedes-Benz E 270 CDI”.

**16.1.** Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e automjetit, përfshirë edhe shpenzimet e zhdoganimit, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 01.01.2008 - 31.03.2008, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën (-) 1.182.252 lekë. Për rrjedhojë, subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe shkronjës “b”, të nenit 33. Ky konkluzion erdhi si rrjedhojë e mospërmbysjes nga subjekti e mungesës së burimeve të ligjshme të konstatuara që me rezultatet e hetimit për pagesën në datën 14.12.2005 e automjetit tjetër, në shumën 500.000 lekë, shitja e të cilit ka shërbyer si burim për mjetin objekt vlerësimi. Komisioni po ashtu ka konstatuar edhe që kontrata e shitjes është kontratë fiktive dhe subjekti/personat e lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të autoveturës objekt shqyrtimi.

**16.2.** Në ankim e parashtrimet në Kolegj, subjekti potencon nën të njëjtën linjë me prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Në mënyrë të përmbledhur, argumentat e saj janë që ajo dhe personat e lidhur, kanë disponuar të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, nga një individ<sup>53</sup> në Gjermani për llogari të djalit të subjektit. Shlyerja e pagesës është kryer me këste deri në muajin gusht 2008, për të verifikuar kushtet teknike të mjetit. Në datën 18.03.2008, është paguar një paradhënie prej 2.400 eurosh, në muajin prill është paguar një këst tjetër prej 4.000 eurosh dhe në gusht të po këtij viti, është paguar kësti i fundit, në shumën 3.800 euro. Këto këste janë konfirmuar edhe nga individ që e bleu automjetin për llogari të djalit të saj. Këstet e paguara provohen edhe nga lëvizjet e llogarisë bankare të djalit të saj të cilat përkrijnë me datat e pagesave. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar një deklaratë dore<sup>54</sup> me deklarues djalin e subjektit dhe shitësin/z. V. H..

**16.3.** Për automjetin që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit objekt kontrolli, subjekti pretendon se kontrata e shitjes nuk është fiktive sa i përket çmimit të shitjes. Në momentin e blerjes, ai automjet ka pasur nevojë për investime, të cilat janë kryer nga subjekti në vitin 2006 pas blerjes, duke ia rritur vlerën. Analiza financiare e Komisionit provon mundësinë financiare të familjes për kryerjen e investimeve në këtë automjet. Çmimi i shitjes nuk ka qenë fiktiv; ai u përcaktua nga gjendja teknike e përmirësuar, përdorimi aftashkurtër [dy vjet] dhe nga kërkesa e tregut. Subjekti kundërshton rezultatin për mungesë burimesh financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës për blerjen e këtij automjeti në datën 14.12.2005. Totali i të ardhurave neto të subjektit dhe të bashkëshortit të saj për vitin 2005 kanë qenë në shumën 2.605.900 lekë kundrejt shumës 2.086.202 lekë të përllogaritur nga Komisioni. Shpenzimet e mobilimit në vlerën 250.000 lekë janë kryer në vitin 2004 e nuk duhen përfshirë në analizën e vitit 2005. Pas saktësisimit të këtyre zërave, balanca e vitit 2005 do të rezultonte negative në një vlerë relativisht të vogël prej (-) 162.405 lekësh, e cila nuk mund të konsiderohet pamjaftueshmëri, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit.

**16.4.** Trupi gjykues vlerëson se pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/i biri, rezultuan edhe në Kolegj me mungesë burimesh financiare të ligjshme, për krijimin e pasurisë objekt analize në vlerën 10.200 euro

---

<sup>53</sup> V. H..

<sup>54</sup> Deklaratë jo noteriale dhe pa datë përpilimi, e depozituar në Komision me prapësimet kundër rezultateve të hetimit.

dhe pagimin e tarifës doganore në vlerën 485.731 lekë në 25.03.2008. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë probleme të besueshmërisë së pretendimeve të subjektit sa i përket mënyrës së pagesës së shtrirë në kohë, shumës së përfituar nga shitja e automjetit tjetër që përbën 2.5 herë vlerën e blerjes, sikurse edhe pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, në funksion të krijimit të kësaj pasurie. Në analizën e kryer në Kolegji, u konfirmua më së paku balanca negative e burimeve të ligjshme e përlllogaritur nga Komisioni për krijimin e kësaj pasurie.

**16.5.** Edhe duke abstraguar nga problematika e besueshmërisë dhe e çmimit të shitjes më të lartë në raport me atë të blerjes, nga kontrolli i analizës financiare në Kolegji, rezultoi se subjekti *nuk ka pasur mundësi financiare* për pagesën e çmimit të blerjes në datën 14.12.2005, prej 500.000 lekësh të automjetit nga shitja e të cilit është gjeneruar fondi që është deklaruar si burim për blerjen e automjetit objekt analize. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij mjeti, afekton përdorimin më pas, të fondeve nga shitja e tij si burime për blerjen e automjetit në vijim. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që konstatimi i mësipërm qëndron edhe nëse në analizën financiare do të përfshihej e gjithë vlera e fituar nga shitja e automjetit në vitin 2007, sipas kreditimit faktik të kryer në llogarinë bankare të djalit të subjektit. Edhe në këtë rast, subjekti dhe personat e lidhur do të rezultonin me mungesë burimesh financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të autoveturës objekt analize dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2008 - 31.03.2008.

**16.6.** Problematika të besueshmërisë u evidentuan edhe në lidhje me kursimet e familjes, të deklaruara në deklaratën *vetting* si burimi i dytë për blerjen e automjetit objekt vlerësimi. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit dhe personave të lidhur deri në datë 31.12.2007, nuk rezultojnë likuiditete gjendje cash në banesë. Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5, germa “b”, të nenit 33 të po këtij ligji. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**16.7.** Pretendimet e subjektit për ta ndarë e shtrirë në kohë pagesën e kryer për automjetin në vitin 2008, sikurse edhe argumentat se automjetin e ka blerë një përfaqësues me prokurë i të birit, i cili ka patur si aktivitet shitblerjen e automjeteve, janë të pabazuara e deklarative pasi nuk ka asnjë akt që të mbështesë ato. Së pari, prokura e pretenduar, nuk rezulton që të jetë dorëzuar në Komision nga subjekti me deklaratën *vetting*, gjatë hetimit administrativ apo pas kalimit të barrës së provës dhe as është pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRr). Po kështu, pagesa e çmimit të shitjes rezulton të jetë kryer njëherësh dhe jo me tre (3) këste sipas pretendimit. Ndër aktet e përcjella nga DPSHTRr-ja, është edhe fatura e datës 25.03.2008<sup>55</sup> sipas të cilës, mjetin e ka blerë vetë djali i subjektit në Bremen Gjermani, kundrejt vlerës 10.200 euro. Sipas përshkrimit në faturë, kjo vlerë është paguar “me para në dorë” dhe është marrë në datën e dorëzimit 25.03.2008. Pasi djali i subjektit ka zhdoganuar dhe shlyer detyrimet doganore në vlerë 485.731 lekë si “importues individual”, në datën 10.04.2008 është kryer kontrolli fizik i mjetit pranë

---

<sup>55</sup> E përkthyer në gjuhën shqipe nga gjuha gjermane dhe e vërtetuar me aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 25.04.2008.

DRrTRrSh Tiranë, nga i cili *nuk* u konstatuan parregullsi dhe në datën 23.04.2008 është lëshuar edhe leja e qarkullimit në emër të djalit të subjektit.

**16.8.** Së dyti, nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit, deklarata e dorës e personit që sipas subjektit ka kryer blerjen fizike “me prokurë”, jo vetëm që është shkresë e thjeshtë, pa datë<sup>56</sup> e për pasojë vetvetiu me vlerë provuese të kufizuar, përpos faktit që është depozituar për herë të parë në një fazë të avancuar të hetimit, me prapësimet e barrës së provës. Si e tillë, kjo deklaratë që bie ndesh me aktet dërguar Komisionit nga DPSHTRr, edhe duke abstraguuar nga problematikat e formës, në përmbajtje nuk përmbush kriteret e pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 për detyrimin e organeve të rivlerësimit të bazojnë vendimin në prova të besueshme e në harmoni me aktet e tjera. Kjo shkresë, jo vetëm që nuk ka asnjë aspekt që të dëshmojë që i përket vitit 2008, për më tepër nuk referon ndonjë aktivitet shitblerjeje automatësh të deklaruesit dhe as që ai ta ketë blerë automjetin për llogari të djalit të subjektit në bazë të një prokure të posaçme. E vlerësuar në raport me provat e tjera, kjo deklaratë nuk është e besueshme. Fatura e shitjes së automjetit, deklarata doganore, certifikata e kontrollit fizik të mjetit të lëshuar nga DRShTRr, referojnë djalin e subjektit si blerës dhe importues individual dhe mjeti nuk ka parregullsi sipas kontrollit fizik të kryer më datë 10.04.2008. Deklarimi në këtë shkresë të thjeshtë për likuidim të çmimit me këste, me qëllim verifikimin e gjendjes teknike të mjetit sipas pretendimit të subjektit, vjen në kundërshtim me faturën e blerjes në Gjermani, me deklaratën periodike për vitin 2008 dhe me deklaratën *vetting*, në të cilat kjo pagesë nuk deklarohet e paguar me këste. Tërheqjet e disa shumave gjatë periudhës shkurt 2008 – prill 2008, sipas statementit të Raiffeisen Bank, provojnë vetëm tërheqjet e si të tilla, nuk mund të kenë vlerë provuese për pretendimin se janë kryer në funksion të likuidimit të kësteve për mjetin. Për sa më sipër, kërkesa për ta shtrirë analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie në një periudhë më të gjatë, deri në gusht 2008, u vlerësua deklarative dhe e pabazuar.

**16.9.** Përsa i përket vlerës së gjeneruar nga shitja e automjetit tjetër në vitin 2007, referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting*, rezulton se djali i subjektit ka pasur në pronësi një automjet [Mercedes Benz, vit prodhimi 1994], blerë më datë 14.12.2005<sup>57</sup>. Sipas kontratës, çmimi i shitjes prej 500.000 lekësh është likuiduar tërësisht nga blerësi, jashtë zyrës noteriale. Në kontratë, në mënyrë të shprehur, referohet se automjeti *rezulton pa të meta apo vese* dhe pasi është siguruar për gjendjen teknike të automjetit blerësi e ka marrë në dorëzim atë. Pas dy vitesh përdorimi, automjeti i është shitur shoqërisë {\*\*\*} ShA më datë 04.12.2007. Sipas kontratës së shitjes<sup>58</sup> çmimi bruto i shitjes ka qenë 1.333.333 lekë. Pasi janë zbritur detyrimet financiare, përfundimisht djali i subjektit ka përfituar shumën neto prej 1.173.333 lekësh. Kjo vlerë është deklaruar si burim për blerjen e automjetit objekt analize. Gjatë hetimit administrativ dhe në përfundim të tij, subjektit të rivlerësimit i është bërë me dije dyshimi për fiktivitet të çmimit të shitjes së këtij automjeti, rreth 2.5 herë më të lartë se ai i blerjes, gati 2 vite pas përdorimit të tij. Subjekti ka pretenduar se automjeti kishte pësuar rritje të vlerës për shkak investimesh.

---

<sup>56</sup> Deklarata nuk ka datë përpilimi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit se është deklaratë e kohës e hartuar në muajin gusht 2008.

<sup>57</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.12.2005, me palë blerëse E. O..

<sup>58</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.12.2007, me palë shitëse E. O. dhe blerëse shoqëria “{\*\*\*}” ShA.

**16.10.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit edhe për këtë aspekt janë deklarative. Në kontratën e shitjes palët janë shprehur se automjeti rezulton pa të meta apo vese dhe blerësi është siguruar për gjendjen teknike të tij. Nga ana tjetër, subjekti nuk depozitoi ndonjë dokument të kohës, që të vërtetonte kryerjen e këtij investimi që pretendohet t'i ketë rritur vlerën automjetit.

**16.11.** Edhe duke abstraguuar nga problematika e besueshmërisë dhe e çmimit të shitjes më të lartë në raport me atë të blerjes, nga kontrolli i analizës financiare në Kolegji, rezultoi se subjekti *nuk ka pasur mundësi financiare* as edhe për të financuar çmimin e blerjes prej 500.000 lekësh në datën 14.12.2005. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij mjeti, afekton përdorimin më pas, të fondeve nga shitja e tij si burime për blerjen e automjetit të deklaruar në deklaratën *vetting*. Për më tepër, edhe nëse në analizën financiare për efekt të blerjes së automjetit objekt analize në vitin 2007 do të përfshihej e gjithë vlera e fituar nga shitja në vitin 2007, sipas kreditimit faktik të kryer në llogarinë bankare, subjekti dhe personat e lidhur do të rezultonin me mungesë burimesh financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të autoveturës objekt analize dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2008 - 31.03.2008.

**16.12.** Në këtë kontroll financiar u verifikuan edhe pretendimet e subjektit mbi pagat e bashkëshortëve O. dhe ato mbi shpenzimet e mobilimit të apartamentit në Plazh, Durrës. Konkretisht, sa i përket pretendimit për pasqyrim të gabuar të të ardhurave nga pagat, nga verifikimi i kryer në Kolegji, rezulton se Komisioni në rezultatet e hetimit, por edhe në paragrafin 12.9 të vendimit, ka cituar balancën negative *të gjithë vitit 2005* [në vlerën 589.172 lekë], për të shprehur pamundësinë e subjektit për të krijuar me burime të ligjshme automjetin e blerë në datën 14.12.2005. Nëse analiza do të kryhej deri në momentin e blerjes së pasurisë, deri në datën 14.12.2005, bilanci negativ do të ishte më i thelluar [në vlerën 793.847 lekë], për shkak se pagat e kredituara në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit gjatë muajit dhjetor 2005, janë përfituar në fakt pas datës 14.12.2005<sup>59</sup> dhe nuk ishin të disponueshme për subjektin dhe personin e lidhur në ditën e blerjes së automjetit.

**16.13.** Sa i përket pasqyrimin të shpenzimeve të mobilimit të apartamentit në Durrës me vlerë totale 500.000 lekë, të cilat subjekti pretendon se janë kryer në vitin 2004, rezulton se në analizën e kryer nga Komisioni këto shpenzime janë ndarë në mënyrë të barabartë në vitet 2004/2005, përkatësisht nga 250.000 lekë në secilin vit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se gjatë hetimit administrativ, subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me këtë shpenzim. Konkretisht, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti ka shpjeguar<sup>60</sup> se mobilimi për apartamentin në Durrës, është kryer *pas vitit 2006*, në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në ankim, subjekti ka pretenduar se këto shpenzime janë kryer *krejtësisht në vitin 2004*. Për llogaritja e kryer nga Komisioni duke i ndarë shpenzimet e mobilimit në mënyrë të barabartë në dy vitet e para pas blerjes së apartamentit në fjalë, duket e logjikshme dhe në linjë me qëndrime të mëparshme të mbajtura për shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit në raste të ngjashme. Megjithatë, nga analiza financiare e kryer në Kolegji rezulton se në cilindo version,

<sup>59</sup> Konkretisht në 16.12.2005 dhe 28.12.2005.

<sup>60</sup> Tekst: "Në vitin 2002 kemi mobiluar apartamentin, në Tiranë dhe pas vitit 2006 apartamentin 1+1 në Plazh Durrës".

qoftë sipas atij të Komisionit apo edhe atij të pretenduar nga subjekti, shpenzimet e mobilitetit nuk përmbysin balancën negative të vitit 2005. Kjo balancë negative do të rezultonte në vlerën (-) 589.171 lekë në versionin e përpjestimit në vitet 2004/2005 të aplikuar nga Komisioni, ndërsa në versionin e përfshirjes vetëm në vitin 2004 sipas pretendimit të subjektit, balanca e vitit 2005 do të rezultonte në vlerën (-) 339.171 lekë.

**16.14.** Problematika të besueshmërisë u evidentuan edhe në lidhje me burimin e dytë për blerjen e automjetit, kursimet e familjes. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit dhe personave të lidhur deri në datë 31.12.2007, nuk rezultojnë likuiditete gjendje cash në banesë. Për sa më sipër, për këtë pasuri trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5, germa “b”, të nenit 33 të po këtij ligji.

**16.15.** Në përmbyllje të pretendimeve të potencuara në lidhje me automjetin objekt ankimi si dhe nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, edhe në Kolegj rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të autoveturës përkatësisht në datat 25.03.2008 dhe 31.03.2008, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2008 - 31.03.2008. Nga analiza financiare e periudhës, rezulton një balancë negative minimalisht në vlerën e rezultuar nga Komisioni (-) 1.182.252 lekë. Në kushtet që ky konstatim qëndron edhe nëse në analizën financiare do të përfshihej e gjithë vlera e fituar nga shitja e automjetit në vitin 2007, sipas kreditimit në llogarinë bankare të djalit të subjektit, pretendimet e subjektit edhe në versionin më të favorshëm për të, kryer si alternativë, janë gjithsesi të pambështetura. Edhe në këtë rast, subjekti dhe personat e lidhur do të rezultonin me mungesë burimesh financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të autoveturës objekt analize dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2008 - 31.03.2008.

17. Për sa më sipër, edhe pas korrektimit të kryer analizës financiare për pretendimet e subjektit që u vlerësuan të bazuara, balanca negative e konstatuar nga Komisioni për çdo pasuri, me përjashtim të vitit 2012, konfirmohet. Si rrjedhojë e kësaj analize, duke pranuar për garanci procedurale qasjen e Komisionit, qoftë për përllogaritjen e balancave, duke marrë në analizë gjithë vitin dhe jo momentin kur janë kryer veprimet financiare, sikurse edhe për aspektet e tjera të analizuar më sipër, për të cilat Komisioni ka favorizuar subjektin, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në Kolegj, zbutet duke u përllogaritur në vlerën prej (-) 6.720.295 lekësh, përkundër (-) 8.077.404 lekë<sup>61</sup>.

**17.1.** Në vijim të këtij konstatimi dhe arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e disa pasurive të deklaruara dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite në kuptim të gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 si edhe ka kryer deklarim të

---

<sup>61</sup> Ndryshimi mes këtyre dy balancave qëndron te mos-përllogaritja e pagesës së pasurisë në Qerret, për të cilën Komisioni ka hetuar fillimisht për fshehje pasurie. Nëse analiza do të kryhej duke mbajtur për bazë momentin kur janë krijuar pasuritë, pa përfshirë investimin për shtëpinë në Qerret, balanca negative e pasurive për të cilat Komisioni ka gjetur mungesë burimesh [përjashtuar apartamentet në Tiranë e Durrës blerë nga {\*\*\*} ShPK] do të ishte 12.983.766 lekë.

*pasaktë* në lidhje me dy pasuri në deklaratën *vetting*, në kundërshtim me detyrimin sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana e vendosin atë në kushtet e *deklarimit të pamjaftueshëm* për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë aplikimin e masës disiplinore të *shkarkimit nga detyra*.

18. Për rrjedhojë, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit *nuk arrin* nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe vendimi nr. 525 datë 27.04.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj e duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 525 datë 27.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Fida Osmani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.04.2025.

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*